

INTERVISTË ME EDITA TAHIRIN

Prishtinë | Data: 4 maj 2018

Kohëzgjatja: 153 minuta

Të pranishëm:

1. Edita Tahiri (e Intervistuar)
2. Aurela Kadriu (Intervistuesja)
3. Donjeta Berisha (Kamera)

Simbolet e komenteve në transkriptë të komunikimi jo-verbal:

() - komunikim emocional

{ } - i intervistuari shpjegon me gjeste

Simbole të tjera në transkriptë:

[] - shtesë e tekstit për të lehtësuar kuptimin

Fusnotat janë shtesa editoriale që japin informacion mbi vendbanime, emra apo shprehje.

Pjesa e Parë

Aurela Kadriu: A mundesh me e prezantu veten edhe me na tregu disa prej kujtimeve të hershme të fëmijërisë t’juaj, domethënë prapavijën familjare edhe çkado që kujtoni ju prej fëmijërisë?

Edita Tahiri: Unë jam Edita Tahiri. Vij nga Prizreni. E njohur për veprimtarinë time si politikane, diplomate, negociatore, si dhe si një prej liderëve kryesor të Lëvizjes për Pavarësi. Në atë kohë Lidhja Demokratike e Kosovës si Lëvizja Paqësore për Pavarësi dhe gjithë rrugëtimi jetësor ka qenë angazhimi për çështje kombëtare, për pavarësinë dhe lirinë e Kosovës. Por kam pasur periudha kur ju kam përkushtuar edhe jetës akademike duke bërë shkollim në “Harvard”, pastaj doktoraturën në “Johns Hopkins” dhe në Universitetin e Prishtinës.

Ma herët kam qenë në magjistraturë në Universitetin e Essex-it poashtu, si dhe në Universitetin e Prishtinës kam bërë fakultetin e elektronikës. Ndërsa pjesën tjetër prej “Harvard” dhe të tjerat ka qenë e lidhur me magjistraturë dhe doktoraturë në shkenca politike. Jetoj në Prishtinë prej kohës kur jam zgjedhur në kryesinë e Lidhjes Demokratike, në vitin 1991. Para kësaj periudhe kam jetuar në Prizren, përveç periudhës së studimeve në Prishtinë dhe në Britani, Essex.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë fëmijëria në Prizren edhe prapavija familjare, prej çfarë familje vini?

Edita Tahiri: Fëmijëria ime ka qenë mjaft e rëndë si edhe e gjithë familjes, për arsye se unë vij nga një familje patriotike. Babai im ka qenë njëri prej veprimtarëve kryesor të lëvizjes ilegale të njohur si Lëvizja Nacional-Demokrate, e cila ka pasur për qëllim bashkimin e Kosovës me Shqipërinë. Dhe për veprimtarinë e tij kombëtare ka qenë i burgosur në periudhën e Rankoviqit, ka qenë një periudhë shumë e randë, ku shqiptarët janë shtypur e persekutuar në forma ma të randa për shkak të angazhimeve për të drejtat e shqiptarëve dhe për angazhimet e bashkimit kombëtar.

Qëndrimi i tij në burg pesë vite, i dënuar nëntë, ishte një kohë që unë sapo kisha lindur, kur ai shkoi në burg unë isha njëmbëdhjetë muajsh, kur u kthye unë veç isha gjashtë vjeçe. Dhe ajo gjendje familjare ku nana s’kishte mundësi të merrej me neve, duhej të punonte për ekzistencën e familjes, por edhe të kujdesej për babain në burg. Për mua, e kam definu si fëmijëri e burgosun, sepse praktikisht e gjithë

koha ka qenë me tragjedinë që kishim por edhe me krenarinë që kishim, sepse nana vazhdimisht na edukonte që të jemi krenarë kur të shkojmë në shkollë apo kur të jemi në shoqëri.

Sepse, “Babai është në burg për gjëra të mira, për gjëra të kombit dhe duhet të jeni krenarë dhe mos të ndiheni keq”. Pavarësisht se konteksti politiko-shoqëror në atë kohë ka qenë që shumica nuk janë angazhuar për çështje kombëtare, pak ka pasë familje patriotike apo individ patriot. Kështu që, ne i takonim kësaj pakice patriotike dhe të tjerët në një mënyrë ishin akomoduar me sistemin komunist edhe me faktin e ndarjes së kombit shqiptar. Kjo nuk ishte diçka e pranuar nga prindërit e mi, por pastaj u bë edhe kauzë e jona si fëmijë të kësaj familje.

Pra, që e kuptuam thellë ndarjen e kombit shqiptar, e kuptuam thellë padrejtësinë dhe nga vinte kjo padrejtësi që kishte ndodhur që shqipëtarët të jetonin në katër - pesë shtete për shkak të vendimeve të asaj kohe të disa fuqive të mëdha e që pastaj u shfrytëzua nga Serbia e Jugosllavia për të shtypur dhe për t'i lënë shqiptarët sa më të prapambetur. Mirëpo, është me randësi kur jeton në familje me një frymë patrotike, krijon një ideal për jetën, krijon një qëllim jetësor. Jo pse unë menjëherë jam marrë me politikë, por ai frymëzim patrotik ka jetu bashkë me mua.

Po ashtu edhe Prizreni si kryeqytet i shqiptarisë na ka dhanë një frymëzim shtesë, sepse si fëmijë shpesh e vizitonim [Lidhjen e Prizrenit]. Pra ky është konteksti me të cilin unë jam rritur si fëmijë kam qenë nxanëse e shkëlqyeshme, në të gjitha fazat, edhe shkolla fillore edhe shkolla e mesme. Për nga ato përshkrimet që i bën familja thonë që kam qenë e urtë, e sjellshme. Dhe pastaj kur unë u angazhova si një prej themeluesve të Lidhjes Demokratike në Prizren, në kundërshtim të okupimit serb edhe për familjen dukej disi si një energji apo një forcë e brendshme që u zhvillu te unë dhe pastaj shpërtheu në kuptimin e angazhimit të drejtëpërdrejtë për themelimin. Dhe pastaj shpejt u zgjodha edhe në udhëheqjen e Lidhjes Demokratike.

Kam qenë dhjetë vjet Ministre e Jashtme e Republikës së Kosovës prej '91 deri në vitin 2000. Pasi që u çlirua Kosova, pastaj erdhën institucionet e UNMIK-ut, por deri atëherë unë kam vepruar pra si Ministre e Punëve të Jashtme. Arsyeja pse jam zgjedhur në këtë detyrë nuk ka qenë se kam pasur ndonjë përvojë politike apo diplomatike, por për aq sa shpjeguan nga kryesia e Lidhjes Demokratike ka qenë sepse e para vija nga një familje kombëtare, kombëtarisht e formume, patrotike. E dyta, ishte se unë isha shkolluar në perëndim dhe flisja gjuhën angleze rrjedhshëm, sepse siç ju thashë pas universitetit në Prishtinë, unë bëra një magjistraturë në fushën e elektronikës dhe telekomunikacionit në Britaninë e Madhe në Universitetin e Essex-it.

Pra kisha një {hap duart}, një *background* [ang.: prapavijë] që më jipte mundësi të angazhohem në diplomacinë e Kosovës. Ka qenë periudhë tepër e randësishme sepse veprimtaria zhvillohej në Kosovë dhe unë kisha një veprimtari të ndarë në dy pjesë. Një pjesë isha në Kosovë dhe angazhohemi së bashku me gjithë kryesinë dhe kryetarin e LDK-së doktor Ibrahim Rugovën për ta ruajtur rezistencën, frymën, qëndresën e popullit përmes organizimeve që i bëmë. Praktikisht Lidhja Demokratike e

Kosovës si lëvizje për pavarësi ka qenë e suksesshme në kuptimin që i organizoj edhe institucionet shtetërore në rrethana okupimi. Si dhe një drejtim tjetër strategjik kishim ndërkombëtarizimin e çështjes së Kosovës dhe çështjes shqiptare dhe në këtë detyrë unë isha bartësja kryesore si Ministre e Punëve të Jashtme.

Po ashtu mund të them që angazhimet politiko-diplomatike praktikisht më dhanë mundësi që diçka që unë fare nuk e kisha projektuar si mision jetësor, pra që të jem në shërbim të kombit, çlirimit, pavarësisht, këto u bënë tek unë angazhim primar dhe sot e kësaj dite. Pra, këto 30 vjet gjithë angazhimi im dhe përkushtimi lidhet me kombin shqiptar, me shtetin e Kosovës, me angazhimet për ta bërë kombin tonë sa më të fuqishëm, për ta bërë Kosovën një shtet sa më të fuqishëm ndërkombëtarisht, plotësisht të pranuar dhe një shtet euroatlantik pra. Ku vlerat perëndimore, vlerat tona si një komb antik dhe europian të konvergjojnë dhe të jemi pra të integruar në këtë komunitet euroatlantik.

Aurela Kadriu: Kisha dashtë m'u kthyer edhe njëherë te Prizreni, e përmendët që babi ka qenë i angazhuar politikisht, kisha dashtë me na tregu detaje si e keni përfunduar shkollën fillore dhe të mesmen, por edhe me na tregu pak ma shumë se qysh, a është reflektuar angazhimi i babit në jetën e juaj domethënë në shkollë edhe në përgjithësi?

Edita Tahiri: Shkollën fillore e kam kryer afër shtëpisë, në atë kohë është quajtur shkolla "17 Nëntori". Ndërsa, shkollën e mesme në gjimnaz. Për sa i takon ndikimeve që familja apo kombi i kanë përjetuar, babai im edhe pse i torturuar në burgjet e Serbisë, në Mitrovicën e Sremit si një prej burgjeve më të rënda, nuk ka dashur që të ndikojë në orientimet tona. Përveçse, ka vënë një vijë të kuqe, nuk na ka lejuar që të bëhemi anëtar të Partisë Komuniste, sepse ai ishte një demokrat, angazhohej për vlera demokratike. Dhe sepse ai mendonte dhe mendoj që e ka pasë mirë që komunizmi ishte në shërbim të interesave sllave dhe ne shqiptarët praktikisht pësonim prej një sistemi të tillë. Kështu që, kjo ka qenë arsyeja pse unë asnjëherë nuk jam angazhuar në Partinë Komuniste.

Në anën tjetër nuk jam angazhu në Lëvizjen Ilegale siç e ka bërë motra ime e madhe për shembull. Sepse jo që babai synonte të na frikësojë nga angazhimet ilegale dhe rreziqet, por vazhdimisht ka kërkuar nga ne që të jemi të vetëdijshëm nëse marrim vendim për angazhim çfarë mund të pësojmë, sepse ai kishte pësuar. Prej një figure të njohur në qytetin e Prizrenit, prej një pozite të liderit, kur erdhi nga burgu erdhi i sëmurë psikikisht. Dhe unë e të gjithë tjerët jetuam me një baba i cili dhjetë vjet nuk ka pranuar të ulet me neve në tavolinë për drekë. Ka jetuar në një burg shtëpiak pra, për shkak se gjendja e tij psiko-sociale ishte dëmtuar tmerrësisht.

Mos të flasim që rrallë na ka treguar për torturat, por kur u rritëm ne insistonim. Unë insistoja kur u bëra mbi 18 vjet, thashë, "Tash është koha ta kuptoj çfarë kanë qenë torturat". Mund të them që torturat kanë shkuar deri te kurora elektrike e torturimit. Pra, forma të randa që i ka përdorë Serbia dhe strukturat serbe ndaj, kundër shqiptarëve. Dhe praktikisht gjithë ai rrëfimi i tij, por edhe qëndrimi

i tij për mua ka qenë inspirim sepse ai thoshte që, “Kush është në burgjet e Serbisë nuk duhet të akuzohet nëse tradhëton shokun a bashkëpunëtorin”. Por, thoshte, “Unë s’kam mundur ta bëj, prandaj edhe torturimi ndaj meje ka qenë më i madh”.

Edhe është e vërtetë që në atë kohë kur u burgos babai dhe shokët e tij, pas babait askush nuk u burgos sepse babai e ndali, pra arriti që të mos, mos t’i nxjerr shokët e tij dhe kjo ishte një vlerë e madhe. Por, besoj që ka ndikuar edhe në personalitetin tonë edhe timin, që në një mënyrë, çfarëdo pune që bën por sidomos angazhimin kombëtar ta bësh me parime dhe vlera dhe me një ndershmëri ashtu siç e meriton kombi dhe shoqëria. Sidomos për faktin që ne shqiptarët kemi pasur një fat tragjik. Ky fat tragjik i ndarjes kombëtare ka qenë i reflektuar direkt në shtëpinë time, sepse nana ime ishte e Shqipërisë dhe ajo ishte martuar me babain në kohën e Luftës së Dytë Botërore dhe pastaj menjëherë është mbyllur kufiri.

Ndoshta e dini historinë që ne shqiptarët e Kosovës gjatë Luftës së Dytë Botërore nuk kemi dashur të luftojmë kundër okupimit gjerman e italian, sepse në atë kohë ne praktikisht u bashkuam si komb. U hapën shkollat shqipe, filloi një perspektivë. Mirëpo, në fund, në periudhën e fundit të luftës kishte një ofertë nga popujt e tjerë të ish-Jugosllavisë që të na njihet e drejta për vetëvendosje dhe ne të merrnim pjesë në luftë. Ka qenë kjo ngjarje e njohur si Konferenca e Bujanit, e cila ka miratu rezolutë me të cilën Kosovës i lejohet që pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore të mund të bashkohet me Shqipërinë.

Mirëpo, menjëherë pasi përfundoi lufta fillojnë tradhëtitë e strukturave komuniste dhe Kuvendi i Prizrenit, pra parlamenti i... më falni, Parlamenti i Kosovës, Kuvendi i Kosovës u detyrua ta shpall bashkimin e dhunshëm me atë kohë Jugosllavinë dhe Serbinë në të njejtën pako. Pra ne u detyruam përsëri të mbetemi nën dominimin dhe shtypjen e Jugosllavisë, por kryesisht të ekzekutuar nga politikat serbe. Pra desha t’ju them që babai nuk preferoi të ndikoj në angazhimet tona kombëtare, por vet rrëfimi i tij tragjik, vet vizioni i tij dhe përkushtimi për kombin, besoj se janë bërë inspirim për neve dhe për mua dhe poashtu që unë çdo ditë si fëmijë dhe e rritur përballesha me ndarjen e kombit.

Sepse nana ime dyzet vjet bëri përpjekje që të shkoj në Shqipëri dhe ta takoj familjen. Siç e dini kemi pas një Mur të Berlinit shqiptar mes neve pra. Ajo vdiç pa e pa familjen dhe unë kam jetu në një ambient ku nana gati çdo mëngjes ose është zgjuar me ndonjë andërr që ka shkuar në Shqipëri ose me një andërr që ka takuar nanën, vëllain. Pra, kjo është ajo fëmijëri shumë specifike që kam pasur unë. Me një anë babai në burg për një çështje kombëtare, në anën tjetër nana në një mallëngjim të vazhdueshëm për shkak të ndarjes tragjike të kombit. Dhe kur unë e fillova angazhimin në vitet ‘88-‘89, pra ma vonë e kam analizu që gjithë këto rrethana, pra familjare dhe kombëtare kanë ndikuar që në një moment të caktuar unë të përcaktohem për të punuar për idealet kombëtare.

Aurela Kadriu: M’u duk shumë interesant që e përmendët se motra juaj e madhe ka qenë në Lëvizjen Ilegale, a keni ndonjë tregim që ajo ju ka përcjell, qysh ka qenë për juve me pas motrën...

Edita Tahiri: Motra ime e madhe ishte studente në Shkollën e Lartë Pedagogjike në Prizren, studionte matematikën. Dhe ata studentat e Shkollës së Lartë u bashkuan në një grup ilegal, siç u bashkuan në gjithë Kosovën. Këta janë studentat e demonstratave të 1968-tës.

Aurela Kadriu: Aha.

Edita Tahiri: Pra, motra ime ka qenë njëra prej figurave kryesore, në gjithë Kosovën janë mbajtur e në Prizren pra kur është ngritur flamuri... Madje... meqë po flasim për këtë ta bëj edhe një rrëfim për veten në atë kohë. Në kohën kur përgaditeshin për ngritjen e flamurit zakonisht mbledhjet e studentëve mbaheshin në shtëpinë tonë dhe ata kishin nevojë që flamuri të rrethohej, e kishin flamurin por nuk ishte i rrethuar. Dhe unë isha diku, sa i bjen rreth dymbëdhjetë vjeçe dhe kërkuan që unë ta çoj te rrobaqepësi. Unë menjëherë pranova, e dija pranova dhe shkova. Rrobaqepëse ishte nana e njërit prej atyre që ishin pjesë e grupit '68-tës dhe u kry puna, u ktheva, ia dorzova.

Tani kur u bënë gati që të shkojnë tek Lidhja e Prizrenit për ta ngritur flamurin, unë kërkova që të shkoj me ta edhe më tha motra edhe të tjerët, "Jo, jo, ti je e vogël nuk mund të vish". Po thashë edhe unë ja ktheva (qesh), "Nuk isha e vogël për ta çu flamurin" {tregon kahjen majtas}, sepse duhej me shku nëpër qytet, "Pra e bëra këtë dhe dua të jem" edhe vërtet më morën. Pra, që nga ajo kohë kam qenë në një mënyrë indirekte në këto ngjarje edhe praktikisht disa nga shokët e motrës, bashkëpunëtorët janë burgosur edhe motra pas asaj kohe ulërinte intenzitetin e angazhimit si rekomandim i shokëve në burg.

Aurela Kadriu: A mbani mend kështu ma detajisht kur jeni mbledh me shku?

Edita Tahiri: Po aty kemi qenë krejt, ka qenë motra e madhe Shyhretja, pastaj motra me të cilën unë jetoj këtu Myfidja, të gjithë kemi qenë. Edhe më kujtohet që para se të shkojmë tek Lidhja e Prizrenit është bërë një defilim me flamurin shqiptar në të gjitha rrugët kryesore të Prizrenit. Pastaj kemi përfunduar tek Lidhja e Prizrenit dhe dy prej studentave pra arrijtën që ta vënë në shtyllë {tregon lartë} pra tek Lidhja e Prizrenit dhe në momentin kur filloi të valojë flamuri erdhi policia pati menjëherë ndërhyrje, rrahje dhe menjëherë u arrestuan disa.

Megjithatë, efekti i asaj ngjarje ka qenë shumë i madh në Prizren. Pra, ishin shkëndijat e para të një lëvizje të re, sepse ne shqiptarët që nga ndarja tragjike kombëtare në Konferencën e Londrës 1913-tën, kemi pasur vazhdimisht lëvizje dhe rezistenca për vetëvendosje, liri e pavarësi. Dhe këtë ngjarje dhe këto angazhime të studentave... ka qenë një fazë e të gjitha lëvizjeve që i kemi pasur të të gjithë brezave të angazhuar, përfshirë edhe Lidhjen Demokratike si Lëvizje Paqësore edhe Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës si lëvizje e armatosur e shumë të tjera që i njeh historia jonë.

Aurela Kadriu: Në cilin vit keni ardhur në Prishtinë për studime?

Edita Tahiri: Unë kam filluar studimet në vitin 1974, pas përfundimit të gjimnazit kam studiuar siç ju thashë më herët në Fakultetin Teknik, drejtimi i elektronikës me telekomunikacionin. Një fushë që nuk e kisha si preferencë numër një. Edhe këtu dëshiroj të ndaj një, një ngjarje të randësishme. Unë isha vazhdimisht e interesuar që ta studioj psikologjinë, arsyeja ishte që kisha shumë dëshirë të kuptoj gjendjen shpirtërore të babait tim dhe damtimet që ia kishte prurë burgu i Serbisë. Meqenëse, në atë kohë Dega e Psikologjisë nuk ekzistonte në Universitetin e Prishtinës, kishte në Zagreb e qytete tjera. Dhe, meqenëse familja ime nuk kishte fuqi financiare të investojë për studimet e mia, unë u detyrova që të ndërroj pra këtë orientim që e kisha jetësor pra, edhe shpirtëror.

Në atë kohë elektronika dukej sikur ma drejtim modern, Kosova ishte larg ndonjë zhvillimi teknologjik, por ma shumë ka qenë një trend se sa një përcaktim. Dhe, meqenëse mua më mbeti gjithmonë kjo dëshirë e pabaralizuar e studimit të psikologjisë, pastaj unë paralelisht kam bërë jo studime pra institucionale, por vazhdimisht jam marrë me literaturën e psikologjisë, psikoanalizës. Kam lexuar gati të gjithë psikoanalistët e njohur, veprat e tyre. Madje këto ditë do ta sjell edhe atë bibliotekë nga Prizreni, meqenëse më në fund kam kaluar në banesën time pas 30 vjet pune për Kosovën e për kombin.

Pse kam bërë lexim? Jo shumë studim por lexim me shumë vëmendje për të mund... që të kuptoj pak më shumë botën shpirtërore të babait tim, por edhe gjithë shqiptarëve të tjerë që, jo vetëm që kanë qenë burgjeve por edhe të zhdukur, të vrarë e të torturuar e reflektimet e tragjedisë tonë kombëtare tek shqiptarët. Por, fillimisht edhe motivi kryesor ka qenë fati i babait tim. Megjithatë, ai fare nuk e ka bërë si të them çështje sëmundjen e tij, kishte... edhe pse rrinte i izoluar kishte një qëndrim shumë krenar. Nëse eventualisht vendoste të na takojë... po flas për dhjetë vitet [e para], se pastaj ai është rehabilituar. Nëse vendoste të na takojë në korridor apo vinte në dhomën e nejtës, kishte një, do të thosha krenari që reflektonte forcë tek ne, dhe kjo mua më pëlqente.

Për atë, duke e parë gjithë atë mundim... në anën tjetër kishte qëndrim mjaft dinjitoz dhe studimet e mia apo leximet do të thosha aktive në psikoanalizë më kanë ndihmuar që në një mënyrë këtë dëshirë jetësore që pata ta arrij, jo ta shuaj por ta realizoj në një mënyrë individuale. Pra e kam kryer me sukses, shkëlqyeshëm fakultetin e elektronikës dhe telekomunikacionit. Kam qenë studente e mirë, madje ma vonë si mësimdhënëse e këtyre lëndëve e kam shkruar edhe librin e parë në gjuhën shqipe, librin “Elektronika” për shkollat e mesme. Edhe kjo ka ardhë si një nxitje patriotike, sepse kur fillova të jap mësim në Prizren në shkollën teknike, ishte koha e demonstratave të studentëve të ‘81-shit, se unë ‘80-ën diplomova, ‘81 fillova të jap mësim.

Dhe m’i arrestuan disa nxënës, ishte pra një ballafaqim i ri me atë realitetin e ri që kishim dhe atë vit në shtator duke dhënë literaturën në tabelë nxënësve të mi, aty për aty kisha një reagim, pse gjithmonë janë librat në gjuhën serbo-kroate? Pra s’kisha një libër t’ua rekomandoja shqip, por po ashtu me Shqipërinë marrëdhënjet dhe kufiri ishte i mbyllur, nuk kishim mundësi të merrnim libra nga Shqipëria se atje ka pasur libra të shkruar shqip apo të përkthyer dhe ky ishte momenti kur unë vendosa e kam

pasë thanë (qesh) “Ta heq një prej këtyre librave në këtë gjuhë” dhe për disa vjet kam punuar në atë libër, pastaj është botuar nga Enti i teksteve mësimore të Kosovës.

Pra, e zgjodha drejtimin e elektroteknikës dhe telekomunikacionit edhe u angazhova. Po ashtu shkova për studime në Britaninë e Madhe në Universitetin e Essex-it, bëra një master në këtë fushë, në telekomunikacion digjital, i cili ishte po ashtu shumë larg nga realitetet dhe niveli i zhvillimit të Kosovës. Por ishte një angazhim që në të ardhmen do të mund të kontribuoja në, në fushën e telekomit në Kosovë. Mirëpo, jeta ime ndryshoi që nga ‘88, ‘89 kur unë mora orientimin e angazhimeve politike. Dhe pastaj edhe shkollimi u bë në shkenca politike dhe marrëdhënie ndërkombëtare.

[Video ndërpritet]

Aurela Kadriu: A keni mbërri me e konfrontu qoftë ti si më e rritur, mandej qoftë pas leximeve tuaja, babën personalisht, pse ka ndodh ai izolim, ai largim prej familjes?

Edita Tahiri: Siç ju thash ai ishte i izoluar edhe shumë kohë pas burgut, një pjesë të kohës që vinte në dhomën e ndejës ishte koha kur e dëgjonte “Zërin e Amerikës” në radio, pastaj edhe shpejt në televizion sepse nana u angazhu që të blej televizion që baba të ketë mundësi të, ta ketë një komunikim qoftë edhe përmes televizionit. Dhe, në atë kohë kur vinte dëgjonte lajmet ne e pyesnim përse është kaq i përkushtum për këto lajme, çfarë po ndodh? Në këtë pjesë ishte më i hapur, pra rrëfehej politikisht se çka duhet të ndodh me shqiptarët, si do të angazhohet perëndimi, sidomos SHBA-ja. Dhe praktikisht shprehte një lloj optimizmi të matur, se një ditë ne do t’i tejkalojmë ndarjet kombëtare, do ta kemi një fuqi që t’i arrijmë idealet kombëtare.

Mirëpo, pyetjet rreth pasojave që kishte përjetuar në burg i mbyllte. Ka pasë disa momente që unë kam arritur pra të nxisë që të rrëfëhet, dhe zakonisht kjo ka ndodhur kur kemi shkuar në pushimet verore. Në atë kohë, caku kryesor ka qenë Ulqini, një ambient shqiptar dhe ai i relaksim. Aty kam pasë rast që të hap këto tema. Sidomos kur shkonte që të lahet, ja vrejta një shenjë, një gropë këtu mbrapa {tregon me dorë shpinën} dhe prej aty filloi rrëfimi. I thashë, “Çka është kjo?” “Jo, jo...” e minimizoi. Pastaj filloi të rrëfëhet që gjatë torturave e kishte pasë pra {prek shpinën} një lloj damtimi të tillë sa u deshtë të bëhet intervenim kirurgjik {bën sikur qepë me dorë diçka} për ta mbyllur varrën, për shkak të shkelmimeve që kanë ndodhë.

Dhe më kujtohet në atë kohë, jo veç një verë, disa verë unë i shfrytëzoja ku fliste për punën e tij, fliste për lëvizjen në të cilën edhe djali i hallës së tij ka qenë i angazhuar. I cili ka qenë lideri kryesor për zonën Prizren dhe Kukës dhe është zhdukur edhe sot e kësaj dite nuk dihet ku gjendet. Më tregonte angazhimet, pra dhe sidomos lidhjet me një operacion për të sjellë disa parashutista amerikanë (buzëqesh) të cilët në atë kohë kishin për qëllim për të parë gjendjen e shqiptarëve këndej kufirit por edhe në Shqipëri. Pastaj fliste që kanë arritur të krijojnë edhe një radio-lidhje me të cilën ata kanë

mbajtur kontakte Kosovë-Shqipëri, në mënyrë që të formohet një rezistencë ushtarake për të çliruar Kosovën nga Jugosllavia dhe për t'ia bashkuar Shqipërisë.

Më tregonte edhe një rast shumë interesant, një prej shokëve të tij i cili prej malit kishte zbritur për të parë familjen dhe në atë kohë Shërbimet Sekrete Jugosllave e kanë kuptuar dhe kanë shkuar në shtëpi për ta zënë. Ai e paska pasë gjithmonë një strehimore në një dhomë dhe ka hyrë në atë strehimore dhe {mban grushtin afër gjoksit} e ka vrrarë veten, ka pasë bombë me vete. Gjithmonë i përmendte këto situata. Po ashtu i përmendte shokët e tij që i ka pasur në burg, të cilët po ashtu kanë qëndruar shumë mirë, sidomos një shok nga Rahoveci. Ku pastaj ne çdo verë derisa baba ishte në burg, ne e kalonim verën te ata. Arsyeja ishte që ata synonin për ta ndihmu nanën që të mbijetojë, meqë të ardhurat ishin shumë të kufizuara. Ka folur edhe për momente torture, më shumë e ka veçuar këtë kurorën elektrike, ku thoshte që dy javë pastaj më nuk ka qenë i vetëdijshëm. Aty ka pasë ndoshta trajtime mjekësore, por tek pas dy jave ju është rikthyer vetëdija.

Aurela Kadriu: Qysh është reflektu te nana kjo mungesë, është dashtë m'u mbajt vetë?

Edita Tahiri: Nana ishte tërësisht e zënë, i bënte dy punë. Para punonte në një fabrikë të konfeksionit që punësimi i saj erdhi pasi që u burgos baba, dhe meqë baba nuk i tradhëtoi shokët e tij të gjithë ata që mbetën në liri pra u angazhuan që t'i gjenin punë nanës dhe nana detyrimisht u bë rrobaqepëse, mori një kurs u bë rrobaqepëse. Kështu që, një pjesë punonte në punë, pra tetë orë, pastaj punonte në shtëpi. Kështu që, ajo ishte tërësisht e zënë me ekzistencën tonë po ajo që nga nana vlerësoj lart është se ka qenë shumë e përkushtuar që ne të arsimohemi. Tepër, domethënë, kur ishte puna për mësim ajo fare nuk na pengonte për angazhimet familjare.

Po ashtu fliste për familjen e saj e cila në Shqipëri ishte po ashtu e persekutuar të gjithë ishin gjashtë dajë dhe dy teze atje. Ndërkohë, gjyshi im ka qenë prefekt i Kukësit dhe meqenëse një prej dajëve ishte angazhuar kundër regjimit të Enver Hoxhës, kishte përfunduar në burg të përjetshëm. Ai doli nga burgu vetëm kur u bënë ndryshimet demokratike në Shqipëri dhe praktikisht ajo fliste që gjithë vëllezërit i kishte të shkolluar dhe kishte dëshirë që edhe ne të shkollohem, sepse thoshte që, "Kombi nuk mund të ecë përpara pa shkollim". Nuk na mundonte shumë, por kishte raste kur rrëfehej për andrrat apo kur e kapte malli për familjen, sigurisht nuk mundte t'i përmbante lotët.

E mbaj në mend këndonte gjithmonë kangë të gurbetit (buzëqesh). Pra kjo është nana ime, po ashtu nana njihet si një prej grave shumë të fuqishme të Prizrenit. Sepse... nuk e di sa e keni parasysh, por në atë kohë regjimi serbo-jugosllav jo vetëm që i burgoste shqiptarët patriotë, por kishte tendencë që të abuzonin edhe me bashkëshortet. Kështu që, më kujtohet thoshte, "Gjithmonë kur po shkoj në burg i mbaj gërshontë në çantë", si rrobaqepëse ato i ka pasur mjete {bën sikur mban gërshërë në duar}. "I mbaj gërshontë në çantë, nëse ka ndonji tentim që t'i përdorë". Dhe kjo sjellje e saj pra shumë me karakter të fuqishëm, me moral të fuqishëm e ka bërë atë një ikonë në Prizren. Pra, sot kur flitet për gratë e fuqishme të Prizrenit, nana ime hyn në radhën e atyre.

Pra, ka pasë qëndresë me të vërtetë, jo vetëm individuale por edhe kombëtare. Ajo na ka rrëfyer, unë si fëmijë nuk i kam mbajtur në mend, të tjerët vëllezërit dhe motrat besoj i kanë mbajtur në mend bastisjet që janë bërë pasi që babai ka hyrë në burg. Dhe më tregonte që kur ka ardhë si nuse, në pajë e ka pasur flamurin shqiptar dhe thoshte që, “U deshtë të gjejmë mënyrë që ky flamur të mos bie në dorën e policëve serbë”. Dhe, pastaj e kishte shkepur flamurin se ka qenë i punuar me ari në mënyrë që ata të mos e identifikojnë dhe të mos vjen puna me e marrë dhe me nëpërkambë flamurin kombëtar. Janë edhe shumë rrëfime tjera pra të jetës që lidhen me rolin e nanës, por edhe rolin e babës në formimin tim.

Aurela Kadriu: A keni pas rast me e vizitu sa ka qenë në burg?

Edita Tahiri: Po, po, ne... nana shkonte çdo muaj në Mitrovicën e Sremit. Shkonin disa gra (buzëqesh) se kishte disa burra kështu patriotë që ishin në burg në atë kohë dhe të gjithë bashkoheshin. Shkonin me tren prej Prizrenit në Beograd e pastaj vazhdohej, më duket me autobus s’e mbaj në mend mirë. Dhe unë kam qenë disa herë edhe fëmijët e tjerë, me rradhë kemi shku. Një që ma shpjegonte baba dhe që ishte prekë është se kur jemi taku ai më ka marr në grykë dhe më ka përqaftuar unë jam larguar {lëviz duart kah vetja} i kam thanë, “Kush je ti? Nuk je babai im!” Dhe, ai pastaj vazhdimisht ma përmendte këtë moment dhe ai ishte prekur shumë pasi që është kthi në qeli. E mbaj mend pak por këto ata m’i kanë tregu se unë kam qenë një apo dy vjeçe atëhere.

Edhe e mbaj në mend kur u kthi dolën disa lajme dhe ai dërgoi një letër që ka gjasa ta lirojnë para kohës, pra para dënimit dhe atë mëngjes që erdhi nana u ngrit për të shku në punë dhe na porositi të gjithëve që, “Sot ka mundësi që baba të vjen”. Dhe ne e kishim një, do të thosha ndjenjë krejt të veçantë pra gëzimi, hidhërimi, u bashkuan. Pra gëzimi që po vjen, hidhërimi pse ishte, pse u deshtë të jetë atje. Dhe më kujtohet unë isha ende para se të shkoj në shkollë e prisja në lagje dhe një familje në lagje vazhdimisht kujdesej për mu, meqë nana ishte në punë, aty jam rritur, ishte familja Nushi, fëmijërinë... Dhe atë ditë më thanë, “Pse nuk po vjen sot?” Nana shkonte në punë, unë shkojsha te ata, i thashë, “Jo, sot po e pres babain”. Ashtu pastaj ata më tregonin, por edhe vet e mbaj në mend. Dhe krejt kohën kam qenë jashtë dhe derisa erdh... (përlozet). Më shumë s’po muj se po prekem {pin ujë}. Edhe s’kam fol kurrë... moti për këto gjëra...

Aurela Kadriu: A doni me pushu pak?

Edita Tahiri: Mos të foli për nanën se do të prekem ma shumë se njëherë kemi pas shku te kufiri. Po e kryj pastaj ndoshta qetësohem. Patëm shku te kufiri, ne këndeje {me gisht tregon kah vetja dhe përball} doli nana edhe vëllezërit andej, dy anët e kufirit dhe nana fliste me kufitarin, nana e saj fliste me kufitarin e Shqipërisë për të komunikuar, po them janë gjëra shumë të randa. Pastaj gjyshja pas atij momenti kur ka shku në shtëpi është paralizuar dhe krejt jetën e kaloj e paralizuar. Shumë interesante

është jeta, jo vetëm e imja, por jeta me të vërtetë shumë specifike ka qenë. Por shumë shqiptarë i kanë pasë këto tragjedi. Nuk po du me e zmadhu, por e jona ka qenë e tillë.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë konteksti, po mendoj qysh ka qenë për juve '74-tën me qenë studente, '74-ta është themelimi i universitetit kështu tamam?

Edita Tahiri: Universiteti i Prishtinës ishte arritja jonë më e madhe kombëtare, sepse gjithë synimet e strukturave serbo-jugosllave që ishin të orientuara kundër shqiptarëve ishin kundër Universitetit të Prishtinës. Janë të njohura parullat serbe në atë kohë që nuk duhet t'ju jipet universiteti shqiptarëve se pastaj s'mund t'i ndalim kërkesat e tyre për t'u bashkuar me Shqipërinë, do të rriten, do të zhvillohen, do të fuqizohen. Por, vërtetë universiteti është ndoshta fillimi apo baza e pavarësisë që kemi sot, sepse pa komb të shkolluar nuk kemi mundur të përparojmë.

Unë kur erdha në Prishtinë në atë kohë ishte edhe koha kur Kosova kishte marrë një avancim ishte bërë me status federal dhe situata ka qenë pak më e mirë se periudhat e Rankoviqit apo periudhat tjera. Por përgjithësisht ata që kanë dashur ta shohin thellë pozitën e shqiptarëve asnjëherë nuk ka qenë e mirë. Ne vazhdimisht kemi qenë të ekspozuar në burgime, në diskriminime, në pamundësi të kemi qasje në shkollime ndërkombëtare e të tjera. Pra ishte ajo drita e parë (buzëqesh) në tunelin e largët të shqiptarëve këndej kufirit.

Aurela Kadriu: Çka, çka mundeni me na tregu për jetën studentore, qysh ka qenë për juve, si e re keni ardhë në Prishtinë prej Prizrenit?

Edita Tahiri: Po, po. E para Prizreni shumë i bukur, është një ambient inspirues i civilizuar me shumë trashëgimi kulturore kombëtare. Kështu që, ka një fuqi të madhe ajo dalja nga Prizreni, është një sfidë, nuk është e lehtë të shkëputesh. Mirëpo, Prishtina ishte qendra e shkollimit, e botës studentore dhe për mua ishte një risi mjaft e mirë. Megjithatë e kisha me vete atë zhgënjimin që nuk arrita të shkoj në studime për psikologji në Zagreb, megjithatë fillova të futem pra në shkencën për të cilën isha përcaktuar për telekom dhe elektronikë dhe ta ndërtoj shoqërinë time studentore. Duke qenë një person që teknikën nuk e kisha preferencë por ma shumë këto drejtimet shoqërore, shoqërinë e ndërtova të tillë që periudhën e studimeve me kolegët e fakultetit, por pjesën tjetër zakonisht kam qenë në shoqëri me artistë dhe piktorë.

Kështu që, në një mënyrë i kisha dy komponentat që më jipnin të kompletoj atë që unë nga brenda e ndjeja. Kështu që, pjesën e studimeve që nuk kanë qenë të lehta. Pesë vjet studime i kam bërë me angazhim, me bashkëpunim me kolegët, me të gjitha do të thosha përkushtimet që nën një duhet ta kryej shkollimin. Ju spjegova dëshirën dhe andrrën e nanës që të na shoh të gjithëve të shkolluar kjo ka mbjell edhe te unë atë dëshirën për të qenë e arsimuar. Ndërsa në anën tjetër pjesa e daljeve e argëtive (buzëqesh) ka ndodh me shokët e mi dhe shoqet që kanë qenë ose artistë ose piktorë, pjesa më e madhe kanë qenë piktorë, skulptorë. Kështu që, ka qenë një jetë e mirë.

Aurela Kadriu: A keni banuar në konvikt?

Edita Tahiri: Po, kam banuar në konvikt...

Aurela Kadriu: A keni ndonjë kujtim?

Edita Tahiri: ...pjesën më të madhe të kohës.

Aurela Kadriu: A keni ndonjë insert që e kujtoni prej jetës në konvikte?

Edita Tahiri: Të parën po ja u tregoj, sa herë që kam filluar të banoj çdo vit nuk ishte shumë i pastër dhe unë vetë e ngjyrosja dhomën. I merrja të gjitha paisjet, që nuk jam shumë punëtore në këtë drejtim (qesh). Po ishte aq, dhomat ishin të papastërta dhe nuk kisha mundësi ta duroja atë situatë. Kështu që, çdo vjet puna e parë ka qenë, kam marrë çelësat {bën sikur fut çelësat} dhe e bëja ngjyrosjen. Kam pasë cimere, befasoheshin, unë ju thosha, “Veç liromani dhomën une e kryj”, kjo ka qenë. E dyta, problemi i ujit, nuk kemi mundur ta shfrytëzojmë ujin për çdo ditë dhe kjo ka qenë problem sidomos për higjienën.

Pastaj ajo mbajtja e rendit, apo vrapimi që të mbahet rendi, kush i pari, kush... Ka pas disa sfida, kanë qenë të bukura por edhe vështirësuese për jetën. Aty u zhvillu një jetë... konviktet që kam banu unë kanë pasë edhe disa biblioteka, kështu salla ku mund të shkoje për lexim. Pastaj kanë ndodhur ndejtet, shoqërimet, krijimi i shoqërive të reja. Për shembull, pikërisht në konvikt kam takuar një mikeshë që e kam sot dyzet vjet mikeshë, nga Tetova. Pra aty jemi njoftu dhe shoqëria jonë është zhvillu tash dyzet vjet, dhe jo vetëm mes meje dhe saj, por mes motrës sime apo mes familjes time dhe familjes së saj. Ishte bija e shkrimtarit të njohur Murat Isaku, Luljeta.

Aurela Kadriu: Ndoshta me fol edhe pak për ju, keni ardh prej një familje patriotike ma merr mendja që Prishtina ka qenë kulturalisht ma e përzime dhe etnikisht, a ka pasë kontakte mes jush, mes kolegëve serbë, besoj që ka pasë, a ka pasë njerëz serbë që kanë studiu?

Edita Tahiri: Besoj që ka pasë, por nuk mbaj në mend që kemi kontaktuar mes vete, nuk mbaj në mend, ndoshta... nuk po mund ta shpjegoj përse nuk kemi kontaktuar. Por jeta në Fakultetin Teknik ka qenë shumë dinamike, shumë provime, shumë detyra dhe vazhdimisht i ke takuar vetëm ata që t’u ka mundësu ma lehtë. Pra kolegët e grupit, ata që kanë pasur mundësi të diskutojnë për studimet, kështu që nuk mbaj mend kontakte edhe nuk mund ta spjetoj, a ka qenë çashtje nacionalizmi apo për shkak se jeta ka qenë shumë dinamike, jeta studentore dhe nuk ka pasë interesime për këto gjëra.

Aurela Kadriu: A ka pasë në këtë periudhë ndonjë celulë të aktivizmit në të cilën jeni përfshi në ndonjë formë?

Edita Tahiri: Jo.

Aurela Kadriu: Ka qenë një periudhë më...

Edita Tahiri: Ka qenë periudhë e studimeve të mia nuk jam përfshi, pastaj kur u bënë demonstratat e '81-shit unë kisha mbaruar studimet sepse diplomova në dhjetor të vitit 1980. Kështu që, nuk i kam taku këtyre strukturave eventuale.

Aurela Kadriu: Qysh ishte pastaj kur u kthyt prej studimeve në Prizren, po flas në kuptimin e kontekstit politik edhe qysh është reflektu ai tek ju?

Edita Tahiri: Unë kur u ktheva në Prizren vet u përcaktova që të punoj në arsim dhe jo në prodhimtari, sepse profesioni më çonte drejt industrisë e prodhimtarisë. Më shumë preferoja arsimin dhe sapo fillova në janar të vitit 1981, fillunë lëvizjet drejtë demonstratave të marsit. Demonstrata ka pasë edhe në Prizren krahas Prishtinës, ajo u bë ngjarja kryesore e zhvillimeve në Kosovë dhe pati ndërhyrje nga shërbimet sekrete nga Partia Komuniste dhe i arrestuan disa nga nxënësit e mi. Aty kisha një reagim jashtëzakonisht të ashpër, që ndoshta janë edhe fillet e para të patriotizmit tim i cili ishte formuar tek unë, por nuk ishte manifestuar. Mbaheshin disa mbledhje komuniste nëpër kolektive, u mbajt edhe tek shkolla teknike dhe kërkonin që ne mësime dhënësit të distancoheshim nga demonstratat. Unë jo vetëm që nuk u distancova, por bëra një kritikë të ashpër për nxënësit që i kishin marrë të pafajshëm.

Pra, aty fillun ndarjet e para, më kujtohet drejtori u frikësu pas mbledhjes, sikur kishte dëshirë me diskutu me mu që të jem ma e qetë edhe i pata reagu që, "Jo vetëm unë si mësime dhënëse, por ti je drejtori dhe ty të takon nën një t'i mbrosh nxansat pastaj vijmë ne tjerët" por i thashë, "këtu ne... rrugët tona ndahen. Unë kam tjetër orientim, tjetër histori dhe tjetër angazhim, por kujdes edhe ti se në afatgjatë në histori mund të jesh në anën e gabuar", më kujtohet kjo bisedë. Çfarë bëra për ata nxënës, meqënëse ata dy muj i mbajtën në burg, për dy iniciale "KR" burgoseshin njerëzit në atë kohë, "Kosova Republikë", unë u angazhova që kur të kthehen të diplomojnë bashkë me shokët e gjeneratës dhe ja u krijova të gjitha mundësitë, i binda kolegët mësime dhënëse që atyre t'u mundësojmë provimet private.

Pjesa e Dytë

Edita Tahiri: Dhe ashtu u realizua, pra kur u kthyen nga burgu nxanësit gjithë mësime dhënësit ishin solidarë dhe arrijtën të diplomojnë bashkë me gjeneratën. Kjo nuk ishte një zgjidhje vetëm për ta si individë, për mendimin tim ishte edhe një inkurajim për gjithë gjeneratat që të mos frigohen nga rastet e burgjeve apo të shqetësimeve të ndryshme sepse ai ishte fati jonë. Dhe sa më shumë që forcohej gjenerata e re aq më mirë për ardhmërinë. Kështu që, në gjithë shkollën ishte një temë ndër nxënës e ndër mësime dhënëse si arrita që t'ja u mundësoj që ata të diplomojnë bashkë me të tjerët.

Aurela Kadriu: Deri në cilin vit mandej keni punu në arsim?

Edita Tahiri: Kam punuar prej vitit 1981 deri në vitin 1989. Në ndërkohë në vitin '87 kam filluar të punoj edhe në bankë si drejtoreshë e qendrës elektronike, por paralelisht kam vazhduar të jap mësim. Përkushtimi për profesionin e mësimdhënësës më ka dhënë shumë kënaqësi dhe frymëzim, sepse kisha të bëj me gjeneratën e re dhe kisha mundësi që të transferoj njohuritë nga fushat që unë i ligjëroja por në anën tjetër kur je në procese mësimore ke mundësi që të ndikosh tek formimi i personalitetit të gjeneratës së re. Kjo ishte edhe për mua një mundësi që në një mënyrë me ta t'i ndaj edhe ato aspektet e personalitetit të randësisë, e të karakterit e principeve në mënyrë që ata nesër të jenë pra një pjesë vitale dhe pozitive e shoqërisë.

Po kujtoj që ka qenë një mundësi sidomos për nxanësit që vijnë nga fshatrat të kenë mundësi të përballen me një ambient shkollor e civilizues për ta sfiduar vetëveten në kuptimin e përparimeve. E për ata jam kujdesur më shumë në mënyrë pra që të... rrugëtimi i tyre jetësor të jetë ma normal sepse normalisht dallimet fshat-qytet kanë qenë shumë të mëdha në atë kohë. Sot praktikisht për shkak të transformimeve të ndryshme nuk ka shumë dallime por në atë kohë vërtet ata që vinin nga fshati ndiheshin ma inferior dhe pra unë inkurajoja që të mos e ndiejnë këtë dallim. Në anën tjetër shpjegimet që duhej dhanë për rrethanat e demonstratave apo pse bëhen, pse duhen bërë, çfarë janë problemet kombëtare...

Ato i kam diskutuar bashkë me ta por jo gjatë orës, por gjatë kohës së pushimit apo gjatë kohës kur ata merrnin pjesë në demonstrata dhe ktheheshin për të treguar me njëfarë krenarie që kanë qenë dhe kanë vazhduar debatet e tilla. Por, sidomos kur u arrestuan nxanësit, pastaj u bë temë dominante. Në mesin e nxanësve e kam pasur edhe Nait Hasanin, i cili në atë kohë është arrestuar, në vitin 1983, kur unë isha në studimet master në Britani. Nga shkolla mbaj në mend disa gjëra apo disa ndryshime që i solla unë në atë shkollë. E para, shkolla teknike jo veç në Prizren, por gati në gjithë Kosovën ishin shkolla sikur ma të anashkaluara. Zakonisht koncentrimi edhe i kualitet të mësimdhënësve por edhe i nxënësve ishte në gjimnaz. Dhe kur shkova e gjeta një situatë, të them, si kaotike, pa disiplinë, pa respekt, kishte edhe nxënës me tipare, pra të ndonji banditizmi kështu adoleshent e të tjera.

Jam munduar që të ndryshoj kjo dhe ia kam arritur se kam qenë mjaft rigoroze, jam munduar që secili ta ketë të qartë atë definicionin, pra për çka është aty si nxanës ose si mësimdhënës. Pse duhet respekti, pse duhet bashkëpunimi? Po ashtu ndryshimet që i kam bërë lidhen me atë që në shkollën teknike gjeta laboratore, por të pashfrytëzuara, derisa ishin të gjitha mjetet nuk shfrytëzoheshin, dhe landët elektronike kërkojnë anën praktike. Prandaj unë i revitalizova ato laboratore dhe përdorja madje edhe ndihmën e nxanësve, se disa prej tyre kishin fillu angazhimet profesionale nëpër shërbime të ndryshme teknike edhe ata u angazhuan që të sjellin pjesë që mungonin, pjesët elektronike në mënyrë që ushtrime kur i bënim për ta ilustru teorinë u kompletuan.

Dhe praktikisht menjëherë kam zbatuar metodologjinë e ligjërimit teorik dhe punës praktike përmes pra realizimeve që krijonte një plotësim shumë interesant dhe i jepte dinamikë procesit mësimor dhe madje edhe përvetësimi bëhej më i shpejtë. Për shkak se kishin mundësi ta përjetojnë anën praktike, sepse shkenca e elektronikës është abstrakte ndonjëherë, pra ne të gjithë jemi shfrytëzues të teknologjisë informative të paisjeve elektronike, porse çfarë ndodh brenda pak kush e di përveç atyre që janë profesional. Kështu që, ata u mishëruan edhe me proceset e brendshme të gjysëmperçuesve e tjerëve, elemente që përbejnë bazën e elektronikës.

Aurela Kadriu: Më thatë më duket se në vitin '83 jeni shkëputë për master, qysh ka ndodh, qysh erdhën rrethanat që ju vendosët me shku për master?

Edita Tahiri: Në fakt unë pasi fillova të studioj në... më falni, pasi fillova të punoj në Shkollën Teknike paralelisht punës mendova që të vazhdoj studimet e magjistraturës, dhe në vitin 1981 u angazhova që të shkoj në Zagreb e pata mundësinë e regjistrimit dhe e bëra regjistrimin. Fillova të marr ligjërata një herë në muj ishin. Në ndërkohë doli një konkurs për bursat e fondit britanik që jipeshin këtu në Prishtinë dhe konkurova në mënyrë që të ndërpres në Zagreb dhe të vazhdoj në, në Essex, që është në një qytet Colchester, afër Londrës. Fitova këtë bursë të fundit britanik, përzgjodha laminë ku do të, do të studioj dhe aty më ndihmoi edhe mentori im i temës së diplomës, profesor Naim Bejtullahu, me atë u konsultova për temën edhe fushën.

Kështu që, përcaktimi final ishte telekomunikacioni digjital apo transmetimi digjital. Një nivel shumë i avancuar i zhvillimeve teknologjike për atë kohë, por ishte me vizion dhe në pritje që Kosova do të zhvillohej. Sot ne i kemi zbatimet digjitale por ai ishte krejt fillimi i fushës së digjitalizimit. Një vjet qëndrova ishte një lloj masteri i cili nuk ishte *master degree* [ang.: magjistraturë] por master më shumë profesional. Më dha shumë eksperiencë, me mësimdhënës me përvojë, me kolegë nga e gjithë bota. Dhe, po ashtu përvetësova shumë më shumë gjuhën angleze, sepse unë e njihja gjuhën angleze nga shkolla dhe nga interesimet e mia, aty kam marrë edhe mësimet shtesë për gjuhën angleze. Madje me një profesoreshë të cilën tani e kam edhe shoqe, e cila ishte jashtëzakonisht e aftë sidomos për studentat e huj dhe më dha mundësi që të avancoj dhe t'i kaloj provimet e gjuhës me sukses.

Aurela Kadriu: Ju u zhvendosët në atë kohë në Britani, apo jo?

Edita Tahiri: Po jetova në Britani dy semestra, pra të një viti kalendarik. Në qytetin ku është Universiteti i Essex-it, në Colchester kam qenë periudhën më të madhe por vikendet i kam kaluar në Londër me disa miq të cilët i njoftova në rrethana kështu aksidentale. Kisha kontakte edhe me disa shqiptarë që jetonin. Kështu që vikendi ishte i shoqërimit, relaksit pastaj vizitat në Londër. Ndërsa, gjatë javës kam qenë rregullisht, kam pasë zyren time meqenëse isha studente por edhe në cilësinë e studiuesit. Kam pasë sidomos kontakte me studenta nga Japonia, të cilët në atë kohë ishin pjesë e ekipit të universitetit për të formësuar makinën e faks... {drejtohet nga kamera} si quhet kjo makina? Faksat që çoheshin, po si të them shqip?

Donjeta Berisha: Printer?

Edita Tahiri: Jo, jo {lëviz dorën horizontalisht} këto që... përpara s'ka pas email-a me faks, me letër...

Aurela Kadriu: S'e di qysh e ka emrin...

Edita Tahiri: Veç po e pe dini cilën {lëviz dorën horizontalisht} që vinte me letër, letër.

Aurela Kadriu: Po, po.

Edita Tahiri: Nejse, {i drejtohet kamerës} ti e pren {bën sikur mban gërshërë} këtu se ta kam prish.

Aurela Kadriu: Mundesh me vazhdu fjalinë.

Edita Tahiri: Po, pra në atë kohë ata punuan dhe deri sa isha unë aty u zbulu makina për dërgimin e faksave ishte një gëzim i madh për gjithë universitetin (buzëqesh) por edhe për mua një njohje për diçka që po vinte, dhe ma vonë secili e kemi përdorë një kohë. Tani nuk përdoret gati fare, por një kohë faksi ka qenë makina kryesore për komunikime të shpejta të lajmeve apo korespondencave. Mentori im gjatë atij studimi pra ka qenë një prej profesorave ma të njohur të shkencave telekomunikuese dhe kam përfituar shumë nga udhëzimet e tija se në çfarë drejtimi duhet unë t'i thelloj njohuritë në transmetimet digjitale. E çmoj lartë që ka qenë aq përkrahës në atë proces.

Aurela Kadriu: Qysh ka qenë për juve në atë kohë nuk është që kanë udhëtuar shumë njerëzit prej Kosovës në vende të Evropës, a mundesh për këtë pjesë me na tregu, për familjen por edhe për juve qysh ka qenë që po shkon një vajzë prej Kosovës në Britani në atë kohë?

Edita Tahiri: Pyetje interesante por unë e kisha sfidu familjen shumë ma herët. Në kohën kur isha në gjimnaz ishin disa programe që nxansat të shkojnë një vjet në Amerikë, ishin disa programe shkëmbimi dhe unë aq shumë e luta babën që të më lejoj se nana ishte dakord, nuk më lejoi (buzëqesh). Mendoj që jam shumë e re të përballem me një shoqëri të avancuar perëndimore, pastaj ishin disa rreziqe që ai i parashikonte vijimet e ndryshme e të tjera. Dhe më pengoi në atë çështje, kështu që kur erdhi puna që pas studimeve unë të shkoj ma ranë këto barrierat se më kishte penguar një herë tani më ranë barrierat.

E më kujtohet i pata thanë nanës që, "Shiko nëse shkoj e më pëlqen ndoshta mbetem" dhe ajo meqenëse kishte jetu me atë mallëngjimin e ndarjes me familjen tha, "Nëse gjen ma mirë thirrëm edhe mua" (buzëqesh). Kishte të drejtë se ajo e dinte çka është mallëngjimi, unë nuk e dija. Unë sapo filloja një jetë jashtë dhe çfarë është fuqia e mallëngjimit apo lidhja me tokën, me njerëzit, me familjen, me kombin dhe nuk pata fare dilemë kur përfundoi ai vit i studimeve të mia, as nuk pata dilema a po

rri a po kthehem, por menjëherë u ktheva. Megjithatë, shkuarja jashtë vendit është përvojë që të sfidon me gjëra që nuk ke pasë në ambientin paraprak. Të hap vizionin sigurisht që mes tjerash janë edhe vështirësitë, sepse duhet të kesh një mundësi për të komunikuar një kompatibilitet në rrethin ku po jeton.

Krejt këto kanë qenë plotësimet që unë i kam vlerësuar. Në anën tjetër ka qenë shumë interesant që kur njoftohesha me profesorët apo studentët në Essex, unë thosha jam shqiptare e Jugosllavisë. Në atë kohë shumica më ka thënë, “Po nuk ka shqiptarë në Jugosllavi”. Kjo ka qenë hera e parë që jam ballafaquar me perspektivën e jashtme për neve {tregon me dorë nga vetja}. Shqiptarët që kishim mbetur padrejtësisht në ish-Jugosllavi, ndonëse ne kemi qenë populli i tretë për nga madhësia në ish-Jugosllavi, pra bota nuk dinte fare që ka shqiptarë, me fjalë të tjera bota nuk dinte që kombi shqiptar ishte i ndarë dhe gjysma kishte mbetur nën dominimet e huaja. Kështu që, pa ndonji parapërgaditje apo plan për të lobizu për kombin, unë vetëm më pengoi shumë që nuk dinin që jemi dhe krejt kohën pastaj kam potencuar këtë. Kjo ka qenë një befasi ndoshta edhe një njohje me atë se ku është Kosova apo ku janë shqiptarët në raport me botë, në raport me marrëdhënjet ndërkombëtare.

Aurela Kadriu: E përmendët ma herët që në vitet ‘88, ‘89 ka ndodhë një kthesë në angazhimin e ju ndoshta tash kishim kalu te qekjo periudhë, me na tregu ma shumë çka ka ndodhë në këtë kohë saktësisht që ka bo kthesën?

Edita Tahiri: Në fakt kthesa tek unë ka ndodh për shkak të kthesave që po ndodhnin në Kosovë e që kishin drejtimin negativ e damtus për Kosovën. Në kohën kur Serbia bashkë me disa struktura jugosllave përgaditën fushatën e okupimit të Kosovës, ajo filloi me një proces të ndryshimit të dhunshëm të Kushtetutës së ish-Jugosllavisë në mënyrë që Kosova ta humbas statusin federal dhe në një mënyrë të inkorporohet në Serbi. Kjo ishte periudha e ndryshimeve kushtetuese të damshme për neve dhe Partia Komuniste mori përsipër që të zhvilloj konsulta me kolektivët në atë kohë, çdo organizatë punuese.

Në atë kohë filluan edhe zërat e para të intelektualëve në Prishtinë, të elitës në Prishtinë, këtyre që ishin kundër ndryshimeve e që ishin pak, por ishin figura elitare, të cilët jepnin pra mendimet e tyre në media. Më kujtohet gazeta “Fjala” ka qenë një prej burimeve kryesore për të zhvillu debate dhe për të dhënë udhëzime se sa të gabushme janë ato ndryshime kushtetuese. Në atë kohë babai im kishte vdekur, pra ishte viti ‘88-‘89, ai ndërroi jetë në vitin 1987 Përndryshe, po të ishte gjallë ai do të më ndihmonte shumë më shumë për të kuptuar se çfarë po ndodhte, meqë unë vet nuk isha e politizuar. Pra, duke ndodh këto ndryshime unë isha në Bankën e Kosovës duke punuar në Prizren dhe fillova në mënyrë do të thosha të pa planifikuar me një vullnetarizëm që unë të angazhohem të diskutoj me kolegë se çka po ndodh.

E para isha drejtoreshë e kisha ekipin tim, por pastaj fillova brenda organizatës të diskutoj në kuptimin që këto ndryshime janë të damshme, këto do ta degradojnë pozitën e Kosovës dhe të shqiptarëve dhe që të punojmë së bashku në bankë që kur të bëhet debati zyrtar të dalim me refuzim. Gjatë kësaj punë pra ishte interesant zyra u kthye në bibliotekë se gazetat dilnin, sidomos gazeta “Fjala” (buzëqesh) dhe të gjithë lexonim pra çfarë po thonë intelektualët në Prishtinë, bota pak fliste në atë kohë për këtë çështje. Disa miq që kisha brenda bankës vet edhe unë pra, krijum një grup kështu të mirëbesimit e të patriotizmit arritëm që të bindim të gjithë shqiptarët (buzëqesh) që punonin në Bankën e Kosovës në Prizren “Bankos” quhej në atë kohë, që kur të vjen debati i organizuar nga Partia Komuniste t’i themi jo ndryshimeve kushtetuese.

Dhe me të vërtetë ajo ishte edhe puna e parë e imja politike, por edhe e suksesshme se me të vërtetë banka që njihej nga nënpunës të pa politizuar e me një prezencë të fuqishme të serbëve në pozicione udhëheqëse në bankë ne arritëm të dalim me konkluzionet që i kemi, “Bankosi” i Prizrenit është kundër ndryshimeve kushtetuese që i kishte parashikuar Serbia. Këtu praktikisht fillon ai angazhim i parë i imi, sepse në gjithë qytetin flitej se cila organizatë përgjigje po i jep ndryshimeve. Kështu që, ne në një mënyrë gati organizata e parë që i thamë jo. I inkurajua edhe shumë të tjerë që t’i thonë jo ndryshimeve kushtetuese. Natyrisht, kjo nuk ishte pa pasoja, sepse pastaj kisha presione të ndryshme jo drejtoresha nuk ishte shqiptare, jo vinin këto figura komuniste, pse? Si? presione. Por presionet unë i përballova se e kisha bërë me bindje të plotë që ndryshimet kushtetuese po damtonin shqiptarët dhe Kosovën.

Pastaj filloi organizimi i sindikatave edhe kjo ka qenë një formë derisa u formu LDK-ja dhe unë menjëherë u angazhova, formum sindikatën e pavarur të punonjësve të “Bankos”-it. Madje aq u organizua mirë, sa me disa kolegë që ishim nga fusha e komunikimit publik ne jipnim edhe deklarata madje i dërgonim në Radio Zagreb, që ka qenë një radio kur Serbia mbylli institucionet mediale i vetmi komunikim publik ishte përmes Radio Zagrebit. Më kujtohen disa deklarata tonat (buzëqesh) që kam nënshkru unë, kanë dalë pra në kundërshtim të okupimit, në kundërshtim të shtypjes, në kundërshtim të tendencave tjera. Dhe krahas këtyre dy veprimeve unë veç kisha hyrë në rrjedhat e formimit të Lidhjes Demokratike në Prizren së bashku me disa kolegë tjerë. Disa i njihja nga patriotizmi familjar, të tjerët i njoftova në proces dhe shpejt formua Lidhjen Demokratike të Kosovës, deri sa në dhjetor u formua në Prishtinë ne në pranverë të ‘90-tave e formua në Prizren.

Për formimin e Lidhjes Demokratike bëmë edhe veprime si gra të cilat ishin me të vërtetë shumë të fuqishme. E para organizua një tubim të madh të grave në hallën e sporteve në Prizren, mund të them ndoshta pesë mijë gra dhe unë dola si udhëheqëse. Nuk kishte udhëheqje, por ne spontanisht dilnim dhe unë dola e lëviza atë proces. Dola dhe e udhëheqa atë tubim që zgjati dy orë, dhe vendimet tona pra, dalja nga sistemi komunist, bashkimi në Lidhjen Demokratike, kundërshtimi i okupimit, angazhimi për liri dhe pavarësi u artikuluan guximshëm nga gratë. Dhe kjo krijoi bazë edhe më të fuqishme që ma vonë jo vetëm që në kryesinë e LDK-së kemi pasë gjysmën burra dhe gjysmën gra, por

po besoj që gjithë këto angazhimet kanë dhanë një shtytje shumë më të madhe asaj që ndodhi, pra lëvizjes gjithëpopullore për pavarësinë e Kosovës të udhëhequr nga Lidhja Demokratike e Kosovës.

Në vitin 1991 Lidhja Demokratike organizoi zgjedhjet e para dhe në ato zgjedhje unë fitova besimin të bëhem anëtare e Këshillit të Përgjithshëm dhe njëherit edhe anëtare e kryesisë së Lidhjes Demokratike të Kosovës, është viti maji 1991 dhe në tetor u emërova Ministre e Jashtme e Republikës së Kosovës. Se ashtu kështu në kryesinë e LDK-së pak kishte që e flisnin gjuhën angleze e komunikimi ndërkombëtar, nën një, kërkon gjuhën. Kështu që, shkollimi në perëndim paraparak, baza patriotike e familjare dhe angazhimi im që të jem pra pjesë e këtyre proceseve bëri që unë të jem një prej udhëheqësve kryesor të LDK-së dhe të marrë dhetë vjet detyrën e ministrit të jashtëm.

Mirëpo, nëse më pyetni cili është momenti emocional që unë ma s'kisha alternativë tjetër përveçse të ndihmoj që të qetësoj shpirtin, ishte vrasja e disa fëmijëve në oborrin e shkollës fillore në Zhur. Ky ishte ndoshta fillimi, janari apo shkurti i vitit 1990 unë në atë kohë nuk punoja se na nxorën prej punëve por kontaktet e mia për formimin e LDK-së pra bënë që ne të gjithë themeluset të shkonim në vizitë tek familjarët. Shkuam edhe në shkollë dëgjuam rrëfimet, ai ishte moment përcaktues që jeta ime prej atij momentit e tutje të jetë përpjekje maksimale që të ndalet shtypja, vrasja, tortura ndaj shqiptarëve dhe ne më në fund të dalim aty ku na takon pra të jemi të lirë, ta kemi shtetin e pavarur dhe të krijojmë një demokraci që do t'i shërbej të gjithëve.

Aurela Kadriu: Qysh ka ndodh përjashtimi prej pune i shqiptarëve të '90-tat në Prizren?

Edita Tahiri: Sikur edhe në gjithë Kosovën angazhimet për t'i thanë jo ndryshimeve kushtetuese, edhe pse pastaj parlamenti komunist i asaj kohe në Kosovë u detyrua t'i thotë jo. Por debati publik solli një "JO" të madhe kundër ndryshimeve kushtetuese dhe ky debat dhe ky angazhim krijoi një proces, një lëvizje që ma vonë rezultoi në formimin edhe të Lidhjes Demokratike të Kosovës si lëvizje e parë në proceset e ish-Jugosllavisë e cila ishte jo vetëm demokratike por edhe kombëtare në kuptimin e angazhimeve për ardhmërinë e shqiptarëve dhe të Kosovës. Dhe praktikisht ky ishte ai procesi që krijoi pra ardhjen e shumë intelektualëve në procese që do të çonin përpara ardhmërinë tonë.

Aurela Kadriu: Qysh kanë qenë dhjetë vjet si ministre?

Edita Tahiri: E para Kosova e okupuar, ka qenë një gjendje me të vërtetë shumë e randë, sepse Serbia me të gjitha mekanizmat jo vetëm të forcave ushtarake por edhe policore, paramilitare, shërbimet sekrete, është përpjekur që të shtyp lëvizjen për pavarësi, të arrestoj, të vraj, të frikësoj në mënyrë që ne të zbrapsemi. Pra ishte një gjendje jashtëzakonisht e randë. Sidomos më kujtohen demonstratat e popullit që kanë qenë masovike në atë kohë, përfshirë edhe protestat e minatorëve e të tjera. Në ato protesta kishte shumë shtypje ndaj shqiptarëve sidomos është edhe një moment përcaktues për mua, për angazhimet kur filluan qytetarët të lodhen nga vrasjet, e lëndimet e shtypjet, protestonin por pastaj uleshin në mënyrë që ta amortizojnë sulmin e forcave serbe.

Kam qenë shumë e prekur duke e parë kombin të ulur, kisha frikë se po nënshtrohem {përkul trupin poshtë} dhe kjo edhe më shumë e ka forcuar përcaktimin tim që të jem ku është e mundur për të ndihmuar kombin dhe çlirimin. Kështu që, këto rrethana dhe angazhimi politik në krye kur je më i rrezikuar nga ana e okupatorit kanë qenë dy komponenta që shkonin në shpirtin dhe mendjen time. Pra, kisha shumë vullnet, shumë frymëzim, kisha shumë dhembje, por nuk guxoja që t'i nënshtrohem emocioneve sepse do të më pengonte në punë. Prandaj i kam pasë dhënë detyrë vetes që të punoj, sepse ne nuk kishim mundësi t'i mbrojmë njëqind përqind shqiptarët nga vrasjet e okupatorit serb.

Por kishim mundësi atë që e bëmë, pra Lidhja Demokratike e Kosovës përcaktoi drejtimet strategjike. E para ishte që të krijojmë institucionet shtetërore në Kosovë edhe në rrethana okupimi, drejtimi i dytë strategjik ishte ndërkombëtarizimi i çështjes së Kosovës dhe çështjes shqiptare në mënyrë që të bëjmë botën të njeh tragjedinë që po ndodh në Kosovë, dhe të na përkrah për pavarësi dhe vetëvendosje si dhe në anën tjetër ishte vazhdimisht angazhimi që përmes takimeve, tubimeve, mbledhjeve të bisedoj me qytetarët në emër të ngritjes së moralit, të rezistencës dhe në emër të qendresës dhe që të pengojmë që okupatori mos të gjej mes shqiptarëve ndonjë kolaboracionist. Dhe mund t'ju them pra me sukses kemi arritur që ta mbajmë unitetin dhe homogjenitetin e popullit për dhetë vjet. Pra, rreth qëllimit të përbashkët që ishte {numëron në gishta} pavarësia e Kosovës, rreth qëllimit të përbashkët që të korigjohet padrejtësia kombëtare ndaj shqiptarëve dhe rreth qëllimit të përbashkët që kthim mbrapa më nuk mund të ketë dhe se pavarësisht Millosheviqit dhe një regjimi të terrorit shtetëror ne do t'ia dalim. Dhe gjithë këto dhetë vite kanë qenë ky angazhim.

Për mua angazhim kryesor ishte që të udhëtoj në botë për të ndërkombëtarizuar çështjen e Kosovës, për të shpjeguar arsyet, shkaqet e luftës në Kosovë, për të argumentuar pse Kosova dhe populli i saj e meriton shtetin e pavarur mbi argumente politike, argumente juridiko-kushtetuese, argumente etnike, historike. Sepse të gjitha këto argumente ishin në anën tonë {tregon kah vetja}. E para ne ishim kombi i ndarë, kundër vullnetit tonë ne mbetëm këndeje kufirit, e dyta ne ishim popull autokton, shqiptarët dhe grekët janë popull autokton në Ballkan, të tjerët janë të ardhur. Pra këto ishin tokat tona dhe në këto toka ne kishim arritur të mbeteshim shumicë përkundër shumë deportimeve që i kanë ndodhë shqiptarëve. Gjatë shekullit XX kanë ndodhë katër, pesë valë të mëdha të deportimesh, pra dëbimesh drejt Turqisë kryesisht, me qëllim pra që të pastrohen këto tokat shqiptare nga shqiptarët.

Kështu që, këto kanë qenë argumentet historike për të shpjeguar, pastaj ka qenë argumenti juridiko-kushtetues që e para Kosova ka qenë njësi federale, ish-Jugosllavia është zhbërë dhe si një njësi federale na takon e drejta për vetëvendosje dhe suksesion, sepse ne kemi qenë sikur edhe shtatë njësi të tjera federale me të drejtë të vetos në kryesinë e ish-Jugosllavisë. Pra, me kushtetutë të analizuar mirë e drejta jonë buronte nga Kushtetuta. Po ashtu, argumentet ishin politike që lidheshin me vullnetin politik të popullit për pavarësinë e Kosovës, pra deklarata e 2 korrikut 1990, me të cilën shpallëm pavarësinë e Kosovës, pastaj u mbajt referendumi për pavarësinë e Kosovës në shtator të vitit 1991. Pastaj ishin zgjedhjet e para multiparlamentare, gjithë këto përbënin argumentet tona

politike se pavarësia e Kosovës është rezultat i vullnetit të popullit shumicës shqiptare në Kosovë që është dy milion, dhe që legjitimiteti buron nga këto argumente.

Po ashtu, spjegojmë që zhbërja e ish-Jugosllavisë ka qenë domosdoshme, erdhi si rezultat i ndryshimeve të mëdha në Evropë, ramjes së komunizmit, Murit të Berlinit si dhe hapjes së perspektivës së demokracisë dhe vetëvendosjes së popujve të shtypur. Pra, ishin rrethana jo vetëm të brendshme por edhe rrethana ndërkombëtare, të cilat na krijuan mundësi që të argumentojmë. Natyrisht argumentet që i kam bërë unë këto dhjetë vitet e okupimit jam munduar t'i bëj të sakta, argumentet që janë të kuptueshme për faktorin ndërkombëtar, pa ekzagjeruar sepse kishte mjaft argumente në anën tonë. Nuk kishte nevojë që të ekzagjeroheshin, si dhe jam munduar që të jem e saktë në dhanjen e elaborimeve dhe mesazheve në mënyrë që të forcojmë imazhin se ne shqiptarët po kërkojmë shtet, por kemi edhe kapacitete për ta bërë shtetin.

Nuk kam pasë përvojë në fillim, por ka qenë ai sistemi duke parë duke bërë apo *learning by doing* [ang.: duke bërë, duke mësuar]. Kështu pra edhe unë e kam përvetësuar praktikisht punën e diplomacisë dhe marrëdhajeve ndërkombëtare. Natyrisht në atë kohë jam munduar të lexoj shumë në mënyrë që të mos reflektoja pozitivisht fillestare. Nuk ka qenë lehtë, më kanë ndihmuar shumë studimet në Britani, komunikimet ndërkombëtare, gjuha angleze. Por, ma shumë se kaq, gjithmonë kam qenë serioze në çfarëdo pune që kam bërë edhe kur kam studiuar në Prishtinë, edhe kur kam dhanë mësim, edhe kur kam shkruar libër shkollor. Pra, e kam si një lloj përcaktimi që punën që dëshiroj ta bëjë e bëjë me kualitet dhe me seriozitet dhe sidomos për ta ndihmuar çlirimin e kombit. Kisha shumë më shumë frymëzim {shtrëngon grushtin}, shumë më shumë motiv që ta bëjë sa ma mirë.

Aurela Kadriu: A keni qenë pjesë e organizimit të sistemit paralel në Kosovë?

Edita Tahiri: Po ajo ka qenë krejt punë e Lidhjes Demokratike të Kosovës si lëvizje për pavarësi, pra duke qenë në udhëheqje të lëvizjes, pra gjithë arkitektura e sistemit paralel shkollor ka qenë e bërë nga ne. Si udhëheqje, por edhe degët e LDK-së në Kosovë dhe në diasporë. Ndërsa, unë veçanërisht jam ajo që e kam hartuar arkitekturën e Ministrisë së Punëve të Jashtme të Kosovës dhe orientimet strategjike. Orientimet tona strategjike në politikën e jashtme ishin orientime perëndimore dhe ne, synimi jonë ishte që të bindim Shtetet e Bashkuara të Amerikës të vëhet në përkrahje dhe vendet perëndimore evropiane. Kështu që, këtë vizion të politikës së jashtme bashkë me një arkitekturë, kur po them arkitekturë nuk kemi pasur një ministri që të jetë në kushte normale por unë ndërtova ekipe.

Për shembull, rreth meje si ministre e kisha një ekip këshilltarësh që vinin nga të gjitha fushat e randësishme, nga fusha politike, nga fusha historike, demografike, pastaj nga marrëdhajtjet ndërkombëtare në mënyrë që të kem bashkëpunorë në procesin e zhvillimit të diplomacisë. Po ashtu, në kohën kur u bënë zgjedhjet në vitin 1992 doli parlamenti i parë demokratik në Kosovën e okupuar, Komisioni për Politikë të Jashtme i parlamentit që u zgjodh në atë kohë. Parlamenti nuk ka arritur të konstituohet shkaku i pengesave nga okupatori serb, por komisionet janë konstituar dhe komisionet

ishin të përbërë nga më shumë parti, sepse pos LDK-së në atë kohë po vepronin edhe disa parti të tjera si Partia Fshatare, Socialdemokrate, Demokristiane. Kështu që, ata u bënë pjesë e komisionit dhe ata ishin po ashtu pjesë e diplomacisë.

Pastaj kisha ndërtuar grupe profesionale të fushave politike, ekonomike, fushës së sigurisë, fushës marrëdhënjesh ndërkombëtare, fushës juridiko-kushtetuese të cilët pra ndihmonin përgaditjet në platformat tona diplomatike. Ma vonë në vitin 1995 unë e themelova edhe Qendrën për Studime Ndërkombëtare të Kosovës në kuadër të Lidhjes Demokratike, ku u angazhuan disa pra ekspertë, analistë dhe e bënë punën e tyre për të analizuar rrjedhat ndërkombëtare dhe avancimin e pozitës së Kosovës në marrëdhënjet ndërkombëtare. Ato analiza kanë qenë shumë të vlefshme për të pa se si po rritet diagrami i përkrahjes së botës, veçanërisht të partnerëve perëndimor ndaj pavarësisë dhe ndaj angazhimeve për ta ndalur luftën dhe përfundimisht Kosova të dalë e lirë dhe e pavarur. Pra, kjo arqitekturë ka qenë ajo që unë e kam hartuar dhe e kam hartuar duke parë rrethanat. Përndryshe, do të ishte lehtë të bëhej Ministria e Jashtme po të ishin kushtet normale se ka shembuj, ka përvoja por kjo ishte diçka autentike, origjinale që përshtatej me mundësitë që kishim neve.

Po ashtu, Lidhja Demokratike Kosovës i kishte degët e saja në gjithë botën, dhe këto degë shërbenin edhe si qendra apo përfaqësi diplomatike. Kështu që, ata u banën sikur ambasadat tona në angazhimet e përbashkëta për ta ndërkombëtarizuar çështjen e Kosovës. Ajo që është me rëndësi të them kur kam filluar takimet e para, pra në tetor të vitit 1991, sapo mora detyrën jam ballafaquar me një realitet shumë të pafavorshëm për Kosovën. Shumica e diplomatëve që i takoja nuk e dinin fare se ku është Kosova. Por ka ndodhur një herë në një zyre ndërkombëtare, unë po flas por bashkëbiseduesi as nuk po e dinë ku është, por për fat e pati globin {me duar përshkruan globin} në zyre dhe mu desht me u afër të globi (buzëqesh) dhe me i tregu {bën sikur prek diçka me gishtin tregues} “Ja kjo është Kosova”. Dhe pastaj për ta shpjeguar kontekstin më të gjërë se Kosova është vetëm një pjesë e çështjes së pazgjidhur shqiptare. E pastaj zakonisht kam folur për çështjen shqiptare, për çështjen e kombit shqiptar, ndarjeve të dhunshme e tragjike dhe kam shpjeguar që Kosova është vetëm një komponent e problemit të pazgjidhur shqiptar. Pra këto janë ato fillimet.

Une shpesh thom që, “Kur e kam filluar diplomacinë, Kosova ka qenë një *terra incognita* [lat.: tokë e panjohur] për botën”. Një vend krejt i panjohur për botën, mos të flas që shqiptarët po ashtu të panjohur sepse edhe Shqipëria ishte në sistemin e Enverit e izoluar, ne të shtypur pamundësi që zëri ynë të ndihet në botë. Dhe për dhetë vjet Kosova arriti jo vetëm të krijoj aleancën me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe që është meritë e Lidhjes Demokratike të Kosovës, por edhe e jona që jemi marrë drejtë për së drejti me diplomacinë, siç jam unë, presidenti Rugova, profesori Fehmi Agani, Bukoshi e të tjerë. Natyrisht, diplomacia jonë u zhvillua edhe ma shumë në kohën e luftës në Kosovë, sepse dalja në skenë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës e forcoi luftën tonë për pavarësi dhe i dha një nivel shtesë ndërkombëtarizimit të çështjes së Kosovës.

Aurela Kadriu: Këta diplomatë që i takojshnit pra në fillimet e karrieres së juv në diplomaci a ishin të ngarkum me propagandë jugosllave apo veç nuk e dishin hiq çka po ndodh?

Edita Tahiri: Në fakt për të dhënë përgjigje dëshiroj vetëm të theksoj që ish-Jugosllavia ka qenë një shtet multietnik, por këtë shtet e kanë udhëheq kryesisht serbët. Ka pas pjesëmarrje edhe nga njësitë tjera federale por do të thosha gjithë pushtetin kryesor në diplomaci, financa dhe ushtri e kanë pasë serbët edhe ata serbë nacionalistë që sidomos ndaj shqiptarëve kanë pasur pozicione armiqësore dhe me skenare të ndryshme ku janë involvuar akademikët e Serbisë skenarët e dëbimit të Shqiptarëve si Vasa Qubrilloviq¹ apo Ilija Garashanin² e të tjerë. Plus, kisha ka qenë shumë e orientuar, Kisha Ortodokse serbe kundër shqiptarëve. Pra kjo, ky ka qenë konteksti.

Duke qenë se serbët kanë udhëhequr diplomacinë e Serbisë në gjithë botën kanë arritur të bindin botën për një imazh negativ për shqiptarët. Pra, propaganda ka qenë e tmerrshme dhe kur unë kam dalë në skenën diplomatike si femër ka qenë një prej sfidave kryesore. Duke qenë se ata janë ushqyer me propagandën serbe sigurisht që ishte befasi që femër e shkolluar anglisht-folëse (buzëqesh), po e përfaqëson Kosovën dhe shqiptarët. Shpesh kam pasë pyetje a jetoj në Kosovë a jo. Sepse kanë mendu që mund të jem shqiptare e diasporës dhe përfaqësoj Kosovën. Pra, thymjet e para të paragjytimeve ndërkombëtare kanë ndodhur sidomos për faktin që unë isha femër (buzëqesh), që sfidonte një imazh që kish vizatu Serbia që shqiptarët janë të prapambetur, të pacivilizum, janë kështu-ashtu. Ndërkohë që, ne shqiptarët dhe grekët jemi popujt antik të këtij gadishulli të Evropës.

Por në marrëdhënjet ndërkombëtare ndërtohen realitete edhe të rrejshme varësisht kush e ka pushtetin në dorë në planet politiko-diplomatike. Pra, ka filluar një ndryshim i cili ma vonë është zhvilluar, forcuar, janë forcuar marrëdhënjet ndërkombëtare. Dëshiroj të theksoj që Shtetet e Bashkuara të Amerikës kanë qenë shteti i parë dhe kryesori i cili është interesuar menjëherë për gjendjen e okupuar në Kosovë, për shkeljen e të drejtave të shqiptarëve, për shkeljen masovike e të drejtave të shqiptarëve. Kanë qenë delegacionet e ndryshme që kanë ardhur të vëzhgojnë se çfarë po ndodh, sa është e thellë shtypja e terrorit shtetëror e politikave të spastrimeve etnike që Serbia i filloi në Kosovë.

Unë shpesh them që, lufta në Kosovë dhe okupimi i Serbisë përbën tri komponentat më të randa të çfarëdo lufte. Pra, ka qenë luftë gjenocidale, luftë e spastrimit etnik dhe aparteidi. Të gjitha së bashku {bashkon gishtat} të kombinuara për të çfarosur shqiptarët nga Kosova, pse? Sepse tokat shqiptare e Kosova kanë qenë të pasura dhe janë sot të pasura për ka pasuritë nëntokësore dhe këto ambicie hegjemoniste dhe kolonialiste kanë pasur për prapavi pra që të, Serbia të merr në dorë pasuritë ekonomike të Kosovës. Por si e kanë menduar nuk ju doli, sepse siç thash ne krijuam një alencë të

¹ Vaso (Vasa) Ćubrilović (1897-1990) ishte historian, politikan dhe akademik jugosllav, i dekoruar me dekoratën e federatës Jugosllave për praktikimin e Doktrinës së shenjt serbe. Njihet për hartimin e studimit “Dëbimi i Shqiptarëve”.

² Ilija Garašanin (1812-1874) ishte kultivues i Doktrinës së shejt serbe, përgaditi platformën në veprën “Načertanja”, e cila bazohej në programin e shfarosjes dhe dëbimit të shqiptarve me dhunë.

fortë me Shtetet e Bashkuara të Amerikës si dhe strategjikisht vendosëm kontaktet dhe thelluam marrëdhënjet me vendet perëndimore siç është Gjermania e cila edhe në kohën e Luftës së Dytë Botërore kishte qenë në krah të shqiptarëve. Pastaj Britania, Franca, Austria, Italia e të tjera mos t'i përmendi. Të gjithat u përfshinë në procesin e përkrahjes për shtetin tonë, por jo e lehtë si proces.

Pjesa e Tretë

Edita Tahiri: Është me randësi të theksoj që në fillimet e diplomacisë dhe ndërkombëtarizimit çështjes së Kosovës, të kuptuarit e botës për Kosovën ka qenë shumë i pafavorshëm për neve. Për shkak se Serbia ka pasë një diplomaci shumë më të avancume në kohën e ish-Jugosllavisë. Pikëpamjet e para e faktorit ndërkombëtar për Kosovën kanë qenë të tilla që Kosova është konsideruar si çështje të drejtave të njeriut. Pra, konflikti i Kosovës si çështje e të drejtave të njeriut. Kosova është trajtuar si çështje e brendshme e Serbisë si dhe rrallë apo gati askush nuk e ka ditur që Kosova nuk ka qenë vetëm një autonomi brenda Serbisë, por ka pasë status federal në ish-Jugosllavi me të gjitha fuqitë si edhe republikat.

Në angazhimet diplomatike, lufta ime por edhe të gjithë që jemi marrë me diplomaci ka qenë që së pari të thehet botëkuptimi që Kosova është çështje e të drejtave të njeriut dhe argumenti që e kam përdor ka qenë se çështja e të drejtave të njeriut në Kosovë është pasojë, ndërsa shkak janë shkeljet e të drejtave kombëtare të popullit shqiptar. Dhe pa u zgjidhur çështja e Kosovës pra, pa u zgjidhur çështja kombëtare me çështje të drejtave të njeriut nuk mund të zgjidhet ky problem. E dyta pra, ky qëndrim se Kosova është punë e brendshme e Serbisë ka qenë po ashtu një cak për ta ndryshuar vazhdimisht duke shpjeguar që Kosova ka qenë pjesë e ish-Jugosllavisë, ky shtet nuk ekziston ma dhe gjithë njësitë federale në baza kushtetuese dhe të vullnetit të popullit kanë të drejtë të bëhen shtete të pavarura.

Ky, ky proces i ndryshimit të qëndrimeve ndërkombëtare ka marrë shumë energji, shumë angazhime shumë pjesëmarrje në takime bilaterale në Amerikë e në Evropë. Unë kam mrrë deri në Japoni që të bëjë pra aktivitete diplomatike për ta ndryshuar këtë qëndrim. Pastaj pjesëmarrja në konferenca të ndryshme botërore, lobizime në OKB, në Këshill të Evropës, Parlament Evropian e shumë aktivitete të tjera që sa ma shumë përmes takimeve me diplomatët të arrijmë t'i bindim që ta shohin Kosovën si status federal dhe jo si një provincë autonome. Natyrisht vitet e para nuk ka qenë lehtë, por ma vonë vetë kemi filluar ta përjetojmë qysh diplomatët e huaj pra kur flisnin për Kosovën flisnin si çështje ndërkombëtare dhe si çështje e statusit federal dhe jo të një province pa të drejta. E treta që ka qenë me randësi, ka qenë argumentimi që pavarësia për Kosovën është një kompromis, zgjidhja e drejtë për Kosovën është bashkimi kombëtar, bashkimi me Shqipërinë jo vetëm i Kosovës por i të gjitha tokave shqiptare që mbetën nën ish-Jugosllavi.

Pra duke përmendur që bashkimi është zgjidhja e drejtë që korrigjon padrejtësinë ndaj shqiptarëve, pavarësia filloi të fitojë në peshë edhe në përkrahje, sepse e shihnin që ka kërkesa maksimale por ne i kemi artikulu kërkesat reale. Kemi pasur nga reagime të ndryshme kur kemi përcaktuar për projektin e pavarësisë nga intelektualë, politikanë në Kosovë apo ndërshqiptar, pse nuk po shkojmë drejt me kërkesën për bashkimin kombëtar. Këtë e kemi spjeguar me faktin që pavarësia e Kosovës për të marrë përkrahje ndërkombëtare duhet ta ketë bazën juridiko-kushtetuese krahas argumenteve tjera dhe në zhbërjen e ish-Jugosllavisë me bazën kushtetuese që ka Kosova mund ta merr pavarësinë. Nëse do të insistonim për bashkim kombëtar, atëherë këtë ne e kishim vënë në kontekstin që nëse ndryshojnë kufinj të brendshëm dhe të jashtëm të ish-Jugosllavisë atëherë edhe ne do të kërkojmë bashkimin kombëtar.

Madje ekziston dokumenti që për mua është një projekt kombëtar në të cilin gjithë partitë politike shqiptare në Kosovë, në Maqedoni, në Luginën e Preshevës, Mal të Zi edhe më gjërë në vendet e ish-Jugosllavisë, në të cilën ne u pajtuam për tre opsione. Opcioni i parë ishte Kosova të jetë shtet i pavarur dhe sovran dhe në atë opcion shqiptarët në Maqedoni të marrin statusin shtetformues, ndërsa shqiptarët në Luginën e Preshevës dhe Malin e Zi të marrin autonomi territoriale. Opcioni i dytë ka qenë, në qoftë se ndryshojnë kufinj të brendshëm të ish-Jugosllavisë atëherë të gjithë shqiptarët në ish-Jugosllavi, Kosova dhe të tjerët ta formojnë një shtet shqiptar këndej kufirit. Dhe opcionin e tretë në qoftë se ndryshojnë kufinj të brendshëm dhe të jashtëm të ish-Jugosllavisë atëherë do të kërkojmë bashkimin kombëtar përmes një referendumi të mbikëqyrur nga faktori ndërkombëtar.

Pra, në një mënyrë elementet apo shtyllat kryesore të argumentimit tonë diplomatik janë përmbledhë në këto pika që ju përmenda, dhe ne vazhdimisht kemi bërë analiza si po ndryshon (buzëqesh) qëndrimi ndërkombëtar ndaj Kosovës. Për shembull, suksesi i parë që unë e quaj të randësishëm ka qenë kur ka dalë rezoluta e parë nga Asambleja e Përgjithshme e OKB-së në vitin 1994 e cila përmendte edhe {formon kllapa me gishta} vullnetin e popullit të Kosovës. Ishte një ndryshim që pastaj unë në takimet e ardhshme diplomatike vazhdimisht i referohesha asaj arritje në mënyrë që rezolutat tjera të dilnin, në institucione tjera lobizoj dhe merrja përkrahje që të figuroj vullneti i popullit. Pastaj filloi qëndrimi ndërkombëtar të ndryshojë në kuptimin që filloi Kosova të përmendej si çështje ndërkombëtare.

Kjo ishte po ashtu një arritje e madhe, pra u harruan tezat se Kosova është punë e brendshme e Serbisë, filloi SHBA-ja, vendet perëndimore të përmendin që Kosova është çështje ndërkombëtare dhe kërkon zgjidhje ndërkombëtare. Ma vonë përmes lobizimeve arritëm që bota ta konsideroj Kosovën jo vetëm çështje ndërkombëtare, por çështje ndërkombëtare e sigurisë e që solli edhe rezolutat e Këshillit të Sigurimit që mbështeteshin në kapitullin e shtatë dhe që lejonin intervenimin ndërkombëtar për ta ndaluar luftën dhe për të gjetur zgjidhje për Kosovën. Këto janë vitet '95, '96, '97, '98, '99, kur Kosova nuk u përfshi në samitin e Dejtonit. Ne paraprakisht biseduam zyrtarisht me qeverinë amerikane se mos eventualisht po harrohet Kosova, morëm garanca që do të mbahet një samit tjetër për Kosovën.

Megjithatë, shqetësimet e popullit u rritën, filloi pra skena ma dinamike e cila me kohë solli edhe daljen në skenë të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës u ashpërsua konflikti, u rritën vrasjet e dëbimet. Në anën tjetër edhe procesi shkonte drejt zgjidhjes dhe zgjidhja e paraparë nga qeveria amerikane ishte që të provohej edhe një herë me një përpjekje diplomatike dhe që ishte konferenca e Rambujesë. Ishte konferenca e parë në historinë e Kosovës pra, konferencë të cilën e udhëhoqi Shtetet e Bashkuara të Amerikës, bashkë me anëtarët e grupit të kontaktit e që ishin Britania, Franca, Gjermania, Italia dhe Rusia. Konferenca e Rambujesë vlerën e kishte jo vetëm se përmbajtja e marrëveshjes i jepte Kosovës mundësi që me referendum të shpall pavarësinë, por edhe jepte mundësi që Kosova të vendosej nën protektoratin e NATO-s. Ka pasë shumë tendenca ndërkombëtare që Kosova të vehej nën protektoratin ushtarak të OKB-së, por ne e kemi refuzuar dhe kemi qenë të suksesshëm. Pra kemi kërkuar që NATO ta mbrojë ushtarakisht, ndërsa pastaj zgjedhja u gjet që politikisht administrata ndërkombëtare të jetë nga OKB-ja.

Marrëveshja e Rambujesë ku ne morëm pjesë, unë isha e vetmja femër (buzëqesh) në delegacionin e Republikës së Kosovës, por propozimi që të jem aty nuk erdhi nga brenda sepse ne asnjëherë nuk kemi pasë propozime. Emrat për pjesëmarrje në konferencën e Rambujesë kanë ardh nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Pra, janë zgjedhur aktorët e lëvizjes paqësore dhe lëvizjes së armatosur. Por ishte fakti që unë isha e vetmja femër plus e kisha postin e Ministres së Jashtme me një përvojë në atë kohë dhetë vjeçare në marrëdhënje ndërkombëtare. Në Rambuje ne arritëm pajtimin mes vete si delegacion që ta pranojmë. Pala serbe refuzoi nënshkrimin e marrëveshjes dhe kjo i dha mundësi pra faktorit ndërkombëtar të merr vendim të intervenoj ushtarakisht. Në krye të këtij intervenimi ishin Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe aleatët veriatlantik të NATO-s.

Dhe këtu mund të them që OKB-ja apo Këshilli Sigurimit të OKB-së edhe pse nxori tri rezoluta që bazoheshin në kapitullin shtatë dhe ku OKB-ja do të mund të autorizonte intervenim ushtarak në Kosovë, asnjëherë nuk e bënë sepse në Këshill të Sigurimit kishte anëtarë si Rusia apo Kina që e penguan, prandaj Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe presidenti Clinton morrën vendimin që të intervenojnë ushtarakisht dhe kështu pra përfundoi lufta, përfundoi gjenocidi. Nxori një bilanc tragjik ku mbi dymbëdhjetë mijë shqiptarë u vranë, rreth tetë mijë u bënë të pagjetur, rreth 20 mijë gra përjetuan dhunimet apo përdhunimet e luftës, shumë fëmijë u vranë, u shkatërrua infrastruktura e vendit tonë. Pra shumë rrëime në planet e banesave, rrëime kulturore e fetare, të gjitha këto Serbia i bëri në procesin e luftës edhe duke e parë që po humbte bëri edhe më shumë shkatërrime. Mirëpo, me randësi që aty u mbyll kapitulli i okupimit i andrrave, iluzioneve të Serbisë që mund t'i bëjë edhe më tutje shqiptarët të shtypur dhe ne dolëm në periudhën e lirisë dhe të ndërtimit të shtetit që jemi edhe sot.

Aurela Kadriu: Ku keni qenë gjatë luftës?

Edita Tahiri: Gjatë... pas kthimit nga Rambuje, Rambujeja i ka pasur dy faza, faza e parë ka qenë rreth tre javë gjatë muajit shkurt, pastaj në muajin mars ka vazhduar edhe një herë derisa ne dhamë përfundimisht pëlqimin për marrëveshje. Pas Rambujesë jemi kthyer në Kosovë, më kujtohet ateruam në Shkup me avion dhe atë mbramje ndejtëm në Shkup dhe Rugova edhe profesor Agani më sugjeruan që unë mos të kthehem në Prishtinë, sepse ne tashmë e dinim që po fillojnë bombardimet. Sepse pas konferencës së Rambujesë shkuam në selinë e NATO-s në takim me gjeneralin Clark³, me atë rast na u shpalos edhe plani i intervenimit ushtarak dhe vendosja e KFOR-it në Kosovë, dhe ne e dinim që po fillonin bombardimet. Profesor Agani dhe presidenti Rugova më thanë, “Ti rri se je femër, rri në Shkup ne po kthehemi”. Natyrisht refuzova thashë, “Jo unë dhetë vjet nuk isha femër (qesh), isha një luftëtare e lirisë, e pavarësisë, njësoj jam edhe tash dhe nuk mund ta marrë këtë vendim derisa populli im është brenda Kosovës unë nuk mund të rri jashtë”. Kështu që, jam kthyer në Kosovë.

Dy javë kam qenë në bodrumin e një shoqes time të studimeve, ku kisha jetuar edhe një vjet në periudhën kur u angazhova në LDK, sepse pjesën tjetër, nandë vjet të tjera kam banuar te Edi Shukriu, e cila po ashtu ka qenë pjesë e lëvizjes për pavarësi. Dhe në bodrumin e tyre rrinim gjatë bombardimeve, ndërsa gjatë ditës në pjesën tjetër të banesës. Në një moment të caktuar kur Rugova u arrestua nga Millosheviqi në shtëpinë e tij në një arrest shtëpiak, fillova të kem dilema athua a duhet të rri apo të largohem nga Kosova. Kam qenë në kontakt me ambasadorin amerikan Christopher Hill, i cili ka qenë edhe kryenegociatori në konferencën e Rambujesë, së bashku me Wolfgang Petrich-in si përfaqësues evropian dhe një përfaqësues rus dhe në komunikimet telefonike që i kam pasur me ta. Megjithëse, telefonat mobil u shkatërruan menjëherë, por në atë ndërtesë një telefon punonte dhe gjithë banuesit në mramje ishim në bodrum dhe këmbenim informata, kështu që kuptum që një telefon funksionon.

Ai telefon mua më shërbeu që të jem në kontakt me Ambasadën Amerikane në Shkup dhe Christopher Hill më njoftoi për qëllimet e Millosheviqit që po provon gjithë udhëheqësat e LDK-së t’i shpiej në shtëpinë e Rugovës për ta shpallur një qeveri vasale. Pra ky ishte plani i Millosheviqit dhe më sugjeroi që nëse do të mundem të largohem. Ky pra ishte ai vendimi që unë mora dhe së bashku me nanën dhe motrën e shoqes ku unë u strehova. Mora dhe Edi Shukriun me vajzën e saj Erëletën, nisëm rrugëtimin si çdo shqiptar për Maqedoni. Pas dy-tre ditësh arritëm në Tetovë, natyrisht me shumë rreziqe. Por krejt dhjetë vjeçari im ka qenë shumë i rrezikshëm, kam mundur çdo moment të vritem. Kështu që, kjo është shkurtimisht, ka shumë përjetime këtu por shkurtimisht kjo është ajo që ka ndodh.

Do ta veçoja një moment nga largimi prej Kosovës në, në Maqedoni. Motra ime e cila kishte dalë ma herët në Maqedoni në atë telefonin {sikur e mban kabllon në duar} që ju tregova që funksiononte më thirri dhe i thashë, “Kam bërë gabim që nuk ta ndala pashaportën apo lejen tande, sepse me dokumentet e mia jam e rrezikuar”. Natyrisht asaj i erdh keq, por unë vetëm ju rrëfeva. Ndërkohë më

³ Wesley Clark (lindur më 23 dhjetor 1944) gjeneral i forcave të armatosura të SHBA-së. Është bërë i njohur në qarqet e gjëra shqiptare pas emërimit të tij komandant Suprem i Forcave të Bashkuara të NATO-s për Evropën më 11 korrik 1997.

lajmëroheshin disa shokë që i kisha prej Shkupit dhe njëri prej tyre vendosi që të ma sjell pasaportën e motrës. Kështu që, e kisha me vete këtë pasaportë kur u nisa. Kur erdhëm tek kufini nga kjo pjesa e Jazhincës ne ishim duke ecur, i lamë veturat larg se nuk lëvizte kolona. Kur erdhëm te kufini u mbyll kufini para neve. Dhe po ashtu Erëleta dhe motra e shoqes time Meli quhej shkuan t'i kërkojnë prindët Erëleta, Edin, dhe Meli kërkonte nanën. Ato u vonuan një kohë, kufini vazhdoi të jetë i mbyllun, një kohë doli policia serbe thanë, “Futuni nëpër vetura”, por ne nuk i kishim, ato veturat i kishim {tregon me dorë djathtas} larg dhe në ecje e sipër unë pash një veturë të zbrazët edhe hyna me gjithë këta si dhe me do fëmijë që ishin me neve që ishim në kolonë, hynëm u bëmë tetë-nëntë veta në një veturë.

Dikur i thash Melit, “Shiko a ke mundësi me shku me pyt pse është e mbyllur, që të dijmë ku jemi, a u mbyll kufiri a?” Ajo shkoi i pyti dhe përgjigja ishte se ata ishin në pauzën e drekës, në atë moment më kujtohet i thashë edhe Edit edhe Melit, “Shiko, nëse hapet kjo unë më nuk ju pres në kërkim që e keni. Mjaft dy orë prita është koha që unë të dalë”. U hap kufini, u nisëm. Më kujtohet pytja e parë e policit, “Ku po shkoni?” Thashë, “Po shkojmë me i marr këto ndihmat humanitare”, se mes kufirit, në zonën mes kufinjëve shpërndaheshin ndihma humanitare të Kryqit të Kuq ndërkombëtar. Me qëllim i thashë këtë fjalë që të mos kërkoj më shumë sqarime tha, “Mirë shkoni”. Ky ishte ai momenti që unë dola. Pastaj Ambasada Amerikane u angazhua me presidentin Gligorov që të hapet kufiri i Maqedonisë, sepse ishte i mbyllun. Po ashtu, unë i kisha me vete gjithë këta fëmijët që ishin në kolonën tonë me vetura, të cilët kur bëhej ditë rrethonin veturën dritaret në mënyrë që paramilitarët të mos më identifikojnë {vendos dorën në gjoks}.

Dhe tani këta fëmijë dhe nanat e tyre erdhën me neve, se baballarët mbetën me vetura. Tani mua m'u krijua mundësia të shkoj në Maqedoni më pyesnin, “A do të na lësh neve?” Fëmijët prej të gjitha moshave {tregon me dorë madhësinë} katër-pesë ndoshta 15-16, i thashë, “Jo, pa juve nuk shkoj askund”. Prandaj është gjetur një telefon aty i veprimtarëve shqiptarë të Maqedonisë, kam thirrë Christopher Hillin i kam thanë, “Unë kam ardhë, kufiri i mbyllun, por nuk dalë vetëm i kam 16 persona” edhe ia kam diktuar të gjitha emrat, ai... meqë për mua hapej {hap duart} kufiri por për krejt këtë grup... Ka shku ka bisedu me presidentin Gligorov, u hap kufiri kaluam ne. Reagimi i njerëzve se pse po hapet pjesërisht, kaluam na, ma vonë dikur u hap kufiri edhe për të tjerët.

Pra janë momente të randa kur njeriu nuk e din a do të ketë shpëtim apo jo. Por krejt këto mua asnjëherë nuk më kanë shqetësuar as në kuptimin e frigës, as në kuptimin e dilemave. Asht interesant kur ke një andërr, ke një ideal dhe ke një popull tandin {i afron duart e bashkuara te gjoksi} që vuan me të vërtetë, çdo gjë shëndrrohet në atë ideal dhe të tjera zhvillime apo rreziqe bëhen të parëndësishme. Me fjalë të tjera, nuk e kam ditur që prej meje si personalitet mund të zhvillohet një figurë që do të mund të jetë e gatshme deri në vdekje të punoj për çlirim e pavarësi. Por këto dhetë vitet që veprova nuk kam pasë asnjëherë frigë, mos të flas se çdo mëngjes kur jam nisur prej shtëpisë tek zyrat e Lidhjes Demokratike këtu në Prishtinë tek Shtëpia e Shkrimtarëve, vazhdimisht kam pasur ndjekje nga shërbimet sekrete serbe. Sot e kësaj dite sa herë që shoh “Golf” të bardhë (buzëqesh) më kujtohet se ata vazhdimisht më kanë përcjellur.

Por shqetësime nuk kam pas edhe gjithmonë e kam një porosi për ato popujt që kanë pra synim çlirimin e që janë të shtypur, që në kohëna lufte e okupimi puna dhe angazhimi vëjnë në plan të dytë çfarëdo frike apo shqetësimi. Pra krijohet një forcë do të thosha e papërshkrueshme e cila të vë në lëvizje dhe nuk... në asnjë moment. Kam qenë edhe e arrestuar disa herë kur shkoja në udhëtimet për diplomaci, për shembull në kufinin Maqedoni-Kosovë, vazhdimisht kam qenë nën këto biseda informative me orë të tëra, ose duke shkuar në aeroportin e Shkupit ose duke ardhur. Apo më kanë arrestu në, prej Shkupit kufirit, më kanë qu në Ferizaj apo raste tjera disa orë e të tjera. Krejt këto pra ishin sikur edhe ato një pjesë suksesit të luftës. Ky pra është ai rrugëtimi shumë krenar, rrugëtim shumë i guximshëm, rrugëtim me frymëzim (buzëqesh) që vetëm ata që janë në këto procese mund ta dijnë sa i fuqishëm është frymëzimi kur ke një ideal e që lidhet me kombin tënd.

Aurela Kadriu: Para se me dal te pjesa e pasluftës po kom qef me u ndal te ni pjesë shumë specifike. Unë e di që Forumi i Gruas i LDK-së sidomos në marsin e '98-tës ka qenë shumë aktiv me protesta dhe organizime. Ndoshta me na fol, ndoshta kronologjikisht për këto protesta që janë organizu në këtë periudhë, e di që secila prej protestave e ka pasë një simbolikë të veçantë. Unë besoj që këto i kujtoni freskët.

Edita Tahiri: Po.

Aurela Kadriu: Nëse mundeni sa ma shumë detaje për këtë.

Edita Tahiri: E para dëshiroj të them që gratë e Kosovës kanë lujt një rol të jashtëzakonshëm në procesin e çlirimit dhe pavarësisë së Kosovës. Dhe një prej forcave kryesore që ka bërë këtë rol ka qenë Forumi i Gruas i Lidhjes Demokratike të Kosovës, që ka qenë e shtrirë në gjithë Kosovën. Në fillim është quajtur Shoqatë e Grave, më vonë ka marr emrin Forumi i Gruas. Ka pasë një zhvillim shumë interesant të Forumit të Gruas në kuptimin e angazhimit për të mobilizuar gratë. Grupi i parë që e themeloi forumin apo shoqatën u shpërbë shpejt. Kur unë erdha në kryesinë e Lidhjes Demokratike forumi ishte krejt i shpërndarë. Unë i dhashë vetës detyrë që të ndihmojë për konsolidimin, dhe në atë kohë punova së bashku me disa gra të tjera që punonin, që ta mbajmë një kuvend dhe të dal një kryesi e re.

Dhe në kuvend u vërejtën disa tendenca, disa gra ishin që ta shkëpusin forumin nga LDK-ja, ndërsa unë dhe disa të tjera që të mos shkëputet, sepse unë vlerësoja që lëvizja për pavarësi, Lidhja Demokratike do të ishte më e fortë poqëse gratë të ishin krah brenda. Dhe aty ndodhën disa tensionime, megjithatë erdhëm në suksesin që forumi mbet mbrenda Lidhjes Demokratike dhe vazhdoi veprimtarinë e saj pra politiko-humanitare. Pse edhe humanitare, sepse përmes qasjes humanitare duke i mbështetur familjet, gratë, ne kishim mundësi më shumë gra të mobilizonim apo mbështetje për fëmijët e të tjera. Në anën tjetër gratë duke u angazhuar në çashtje humanitare filluan të marrin edhe angazhime politike. Pra ishte një strategji shumë e mirë që gratë prej qasjes humanitare të kalojnë dhe të veprojnë politikisht.

Forumi vazhdoi. Ndodhi që kryetarja që u zgjodh në atë kuvend të ikë nga Kosova, mbeti pa udhëheqje. Unë praktikisht kam qenë figura e angazhuar nga kryesia për të koordinu raportet kryesi e LDK-forum, por në anën tjetër të gjitha këto krizat që i kalonte forumi unë i kam udhëhequr dhe nuk kam lejuar që të zhbëhet. Kam pasur angazhime që të mbahet i konsoliduar të mos ndodh që për prishje të vogla siç ndodhi në fillim apo siç ndodhi me ikjen e kryetares vazhdimisht pra, pavarësisht që asnjëherë nuk kanë pranë të bëhem kryetarja e Forumit të Grave, realisht kam qenë liderja shpirtërore e tyre edhe personi kryesor që ja u kam organizu si konceptualisht si për kah fryma dhe mbajtja e mbledhjeve të rregullta mujore e të tjera. Forumi pra randësinë e vet e ka dëshmu se u mobilizua, qindra gra u mobilizuan në kuadër të strukturave të forumit.

Më kujtohet ideja e forumit që nanat t'i mbajnë dy orë mësim me fëmijët nëpër shtëpia pasi që u mbyllën shkollat dhe universiteti dhunshëm nga Serbia, është ideja e parë mbi të cilën ka dalë edhe sistemi i arsimit në Kosovë në periudhën e okupimit kur i organizuam shkollat dhe univerzitetet nëpër shtëpia private. Po ashtu forumi ka vazhduar të jep ndihma shëndetësore grave duke i mobilizuar gratë mjeke. Pastaj kemi penguar tendencën e një fenomeni që u shfaq në atë kohë, elementet e fundamentalizmit u panë në periudhën e okupimit, ku filloi një kampanjë të mbylljes grave {sikur vendos shami në kokë}. Kemi qenë shumë të suksesshme që të çrrënjosim edhe tendenca të tilla e mbi këto të mbajmë moralin e rezistencës duke i mbajtur gratë aktive.

Në periudhat kur situata eskaloj në Kosovë, kur dhuna serbe filloi të përshkallëzohej në masa të paparashikueshme, ne organizuam disa protesta, në mesin e tyre është Marshi i Bukës, me të cilin treguam solidaritetin ndaj Drenicës e cila ishte e rrethuar. Një protestë që arriti të ndërkombëtarizoj çështjen e eskalimit të luftës në Kosovë. Pastaj është protesta për paqë, pra zgjidhje paqësore për çështjen e Kosovës. Po ashtu, unë në vitin 1995 kam arritur që të udhëheq delegacionin prej dhetë grave në Konferencën Botërore të Grave në Peking. Konferenca e cila i vuri bazat e fuqizimit të grave përmes planit akcional. Pra, dhetë gra i kam përfshi në delegacion dhe qëllimi nuk ka qenë që të shkojmë për të fuqizuar gratë, por për të ndërkombëtarizuar çështjen e Kosovës. Madje, në atë kohë edhe posterat të cilat i shpërndamë për propagandë pra ishin të lidhura me fotografinë e nënë Terezës edhe të Rugovës.

Pra kishim materiale propaganduese dhe posterin që e konceptuam ishte që Rugova dhe nënë Tereza të jenë në të njëjtin poster, sepse gratë e njihnin nënë Terezën duke ju afruar asaj do të kuptonin për lëvizjen për pavarësi dhe Rugovën dhe mesazhi ishte "Parandaloni luftën në Kosovë". Krejt këto gra të delegacionit u angazhuan për shpërndarjen e materialeve të ndryshme njoftuse për Kosovën si dhe mbajtëm një *workshop* [ang.: punëtori] në kuadër të konferencës. Natyrisht ne kemi marrë pjesë në pjesën e organizatave joqeveritare, sepse s'kemi mund të jemi pjesë zyrtare e konferencës sepse Kosova nuk ishte antare e OKB-së, plus e okupuar. Por desha të them që gratë me të vërtetë kanë mbri në shumë pikëpamje, edhe politike edhe humanitare, madje edhe diplomatike të japin një kontribut të jashtëzakonshëm për këtë që e kemi sot, pra për lirinë dhe pavarësinë.

Aurela Kadriu: E qysh vjen deri te organizimi serik i protestave të marsit, ndodhën disa protesta?

Edita Tahiri: Ato... motivi parë ka qenë gjendja e randë në Drenicë, pra shtetrrëthimi ushtarak ku popullata vunte për ushqim {numëron në gishta}, për barna, e gjëra tjera. Aty pra idea e parë ishte që të solidarizohemi me Drenicën, në anën tjetër që të rrisim vetëdijen ndërkombëtare që koha është që të ndalet lufta në Kosovë. Menjëherë pas asaj, pas pengesave që na bëri okupatori, pra ne u ballafaquam këtu në Fushë Kosovë drejt për së drejti me forcat policore të Serbisë, u konfrotuam verbalisht është... janë edhe inçizimet e ndërkombëtare të lajmeve si CNN, e EuroNews e të tjera. Ne vendosëm që të bëjmë protestën tjetër në mënyrë që të vazhdojmë se përmes zërit të gruas ta bëjmë botën që të reagoj.

Pra ka qenë protesta e dytë, në atë protestë unë nuk kam qenë për shkak se kam udhëtuar për aktivitete diplomatike ditën e fundit. Por kam qenë pjesë... këto protesta nuk janë organizuar vetëm nga Forumi i Gruas, ka qenë Forumi i Gruas pastaj ka qenë Qendra e Mbrojtjes së Nanës dhe Fëmijës. Në atë kohë Edi Shukriu ishte kryetare e Forumit të Grave, e ndjera Sevdie Ahmeti ishte drejtoreshë e qendrës, bashkë me Vjosa Dobrunën na u bashkangjitën edhe gra të tjera. Pra roli im, ani që nuk isha direkt në Forumin e Gruas, vinte sepse isha një prej udhëheqësve kryesor të Lidhjes Demokratike të Kosovës.

Aurela Kadriu: Protesta e bukës më duket shumë specifike, qysh erdh deri tek ideja që me dal me bukë?

Edita Tahiri: Në fakt kur kemi diskutuar unë, Sevdija dhe Edi, kemi pasë disa ideja. Ka pasë ideja që të përdoret ndonjë element që e karakterizon gruan, por analizat e ndryshme na çonin në përfundim se s'do të duhej ta bëjmë për t'i identifikuar gratë, por ta bëjmë për ta identifikuar qëllimin. Qëllimi pra ishte mungesa e ushqimit, barnave e gjërave higjienike, kështu që prej këtyre të triave na u duk buka (buzëqesh) me një simbolikë më të fuqishme dhe me efekte më të mëdha. Kështu kemi ardhur deri te ky përfundim.

Aurela Kadriu: Po bash ajo kohë është kur ka mungesë të produkteve elementare të bukës, ku e morët bukën, secila nga një bukë?

Edita Tahiri: Po ai ishte (buzëqesh) një organizim shumë i madh, siç ju tregova LDK-ja ka qenë e organizuar në gjithë Kosovën. Furrëtarët ishin pjesë e lëvizjes, kështu që të gjithë këta ishin aktivista dhe lehtë ishte që të trokasim në dyert e furrëtarëve që të... edhe e përcaktum numrin. Pastaj, pasi që nuk arritëm të depërtojmë deri në Drenicë shkaku i pengesave, ne nuk e mbyllëm protestën aty, shkuam tek, në atë kohë ishte jo Ambasada Amerikane por përfaqësia Amerikane ishte hapur në vitin, në janar të '96-tës, dorëzuam një letër me të cilën kërkuam angazhime ma të shtuara të Amerikës. Pastaj shkuam tek furrat dhe i kthyem bukët.

Aurela Kadriu: A u nisët me idenë që keni me mbri deri në Drenicë?

Edita Tahiri: Ne pjesa që ishim duke u marr aktivisht me procesin e pavarësisë e të çlirimit i kemi pasë parasysh edhe pengesat. Mirëpo, kemi qenë të vetëdijshëm që vetë protesta do të jetë një manifestim me efekte të mëdha, sepse mesazhi shkoi në gjithë botën. Madje, kur filluam të konfrontohemi me policinë serbe, unë fola anglisht sepse me atë e dërgova mesazhin në botë. Derisa disa që ishin afër folën shqip dhe serbisht, unë fola anglisht. Pse anglisht? Sepse bota duhet të kuptojë çfarë mesazhi kemi, jo policët serbë, sepse ata ashtu-kështu e kishin vendosë të na pengonin.

Aurela Kadriu: E qysh ndodhi mobilizimi i grave në atë kohë s'ka pasë najfarë mjeti?

Edita Tahiri: Të gjitha janë struktura të Lidhjes Demokratike dhe të forumit, ka qenë komplet strukturë funksionale. Ka mjaftuar një vendim, brenda një periudhe të shkurtë, ke mundur të bësh mobilizimin. Po, natyrisht, ajo nuk ka qenë në atë kohë sot për sot, dikun me sa më kujtohet një javë kanë qenë përgaditjet e çdo ditë jemi takuar si grup organizues.

Aurela Kadriu: Cilat protesta tjera, çfarë simbolikash kanë pasë?

Edita Tahiri: Është e rëndësishme që Forumi i Grave ka bërë edhe një protestë shumë të fuqishme me rastin e vrasjes së studentit Armend Daci.

Aurela Kadriu: Po

Edita Tahiri: Madje kjo protestë vjen pas nja dy-tre vitesh që LDK-ja nuk kishte bërë shumë protesta, se fillimi ka qenë me protesta pastaj një kohë kanë ra, intenziteti i protestave duke i dhanë prioritet diplomacisë, mediave. Kjo theu këtë heshtje, kjo protestë e organizuar nga Forumi i Grave, sepse vrasja e Armend Dacit ka qenë një tragjedi pra...

Aurela Kadriu: Cili vit është kjo?

Edita Tahiri: '94 ose '95. Ka pasë edhe të tjera protesta, po ja u them disa nga këto...

Aurela Kadriu: E kjo marsi i '98-tës u konë me çelësa, me fleta të bardha, si janë bo këto?

Edita Tahiri: Po, po, ka pasë, ato krejt janë manifestime për vetëdijësimin e faktorit ndërkombëtar që të intervenoj. Po ashtu është me rëndësi të theksoj se ne si gra kemi arritë të dërgojmë petition edhe në UNESCO, për mbylljen e shkollave dhe të universitetit shqip në Kosovë. Pastaj në fillimet e okupimit është vrarë një fëmijë me emrin Afrim Prebreza, në një përleshje që fëmijët serbë e vranë, kemi dorëzuar

peticion në OKB në Gjenevë, në Komision për të Drejtat e Njeriut, peticion me qindra-mijëra nënshkrime. Po ashtu, kemi dorëzuar peticion në UNESCO, gratë i kanë organizuar këto (buzëqesh).

Aurela Kadriu: Kishim dalë te pjesa e pas luftës, çka ka ndodh kur ktheheni në Kosovën e pas luftës këtu?

Edita Tahiri: Përfundimi i luftës në Kosovë pra erdhi si rezultat i angazhimit të vet popullit të Kosovës përmes luftës paqësore, luftës së armatosur, por edhe si rezultat i angazhimit maksimal të aleatëve përëndimor në krye me Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Gjithë ajo punë diplomatike e udhëtimeve të mia në Uashington, në Berlin, në Londër, Paris dhe qendrat tjera deri në Tokio por edhe presidentit Rugova e të tjerëve që kanë dhënë kontribut në këtë drejtim si dhe angazhimet e UÇK-së dhe diplomacisë së UÇK-së në dy vitet e fundit, pra sollën atë rezultat për të cilin ne u angazhuam. Kosova u çlirua, aleanca Kosovë-perëndim, Kosovë-SHBA, shqiptar-perëndim, shqiptar-SHBA u konsolidua, dhe sot është vlera kryesore e ekzistimit dhe e prosperitetit të shtetit të Kosovës, si një vend që ka vizion Euroatlantik, integritet në Bashkimin Evropian, në NATO, në OKB.

Në anën tjetër, ne në periudhën e parë të pas luftës nuk ishim ata që e qeverisnin Kosovën, sepse UNMIK-u ishte në krye të proceseve. Dhe dëshiroj t'ju tregoj pse UNMIK-u mori gjithë ato kompetenca dhe pse ne patëm ma pak rol në fillim. Në fakt lufta paqësore dhe lufta e armatosur qëllimin e kanë pasur të përbashkët, por kemi pasë ndasi mes vete. Madje edhe në Konferencën e Rambujesë kemi shku si delegacione të ndara, por atje kemi arritur të bashkohemi në këtë drejtim. Roli im ka qenë kryesor në homogjenizimin e delegacionit, katër orë të mbledhjes së parë i kam udhëhequr unë e ndihmuar nga Bajram Kosumi në mënyrë që ta funksionalizojmë delegacionin dhe që dallimet në mënyrën e çlirimit pra paqësor apo të armatosur të mos jenë ndarje në fuqinë tonë për ta arritur marrëveshjen. Gjatë luftës kishim praktikisht dy qeveri, qeveria e LDK-së dhe u formua qeveria e UÇK-së.

Derisa isha në Maqedoni pra në... si refugjat, vazhdoi puna ime edhe diplomatike edhe politike dhe unë u angazhova që të bëjmë një qeveri të unitetit gjatë luftës, këto janë muajt maj dhe qershor, e ndihmuar nga Qeveria Amerikane e cila pranoi që të ndërmjetësojë formimin e një qeverie uniteti. Unë u angazhova bashkë me ambasadorin Hill, që të kontaktojmë edhe përfaqësuesit e UÇK-së në mënyrë që të takohemi, vendimi ishte që të takohemi në Gjenevë tek selia e SHBA-ve në OKB, që të bashkojmë këto dy qeveri. Përpjekjet për bashkim kanë filluar në Rambuje kur ne morrëm një vendim për bashkim, por që fillunë sulmet e NATO-s dhe ai projekt nuk u realizua. Për fat të keq asnjëherë nuk u arrit që ta bëjmë këtë qeveri të unitetit, sepse disa nga përfaqësuesit e UÇK-së nuk u treguan të gatshëm për këtë projekt dhe erdhi puna që ne të kthehemi në Kosovë me dy qeveri. Dhe pikërisht kjo ndarje e jona e pas luftës krijoi hapësirë që faktori ndërkombëtar të vendos të merr më shumë kompetenca për vete, pra UNMIK-u mori më shumë kompetenca, ndërsa ne kishim ma pak.

Ky ishte një prej mangësive të procesit tonë e cila krijoi disa zhvillimet të mira, por disa edhe krejt të pafavorshme. E mirë ishte që ne po merrnim një përvojë në qeverisje edhe nga UNMIK-u që megjithatë kishte modele interesante të administratës publike e të tjera, por në anën tjetër ne nuk ishim në timon. Kjo krijoi mundësi që politika, pra nacionale, faktori politik shqiptar të mos ketë përkushtim sa duhet për shtet-ndërtimin. Filluan fenomenet e korrupsionit e dukurive të tjera negative, në fillim u arsyetoheshin gjoja UNMIK-ut i ka ndodh e jo ne, ma vonë edhe ne kur morrëm në dorë, nuk punuam me idealizëm. Pra, në një mënyrë interesi nacional që ishte ylli polar për neve në periudhën e çlirimit të Kosovës u zbeh dhe këto dukuri negative e dobësuan procesin e shtet-ndërtimit të Kosovës.

Në anën tjetër në vend se të vendosim baza të forta demokratike, filluan tendenca të autokracisë mes liderëve. Kjo më bëri edhe mua që të braktis në 2004 Lidhjen Demokratike, sepse zhvillimet e mbrendshme nuk ishin demokratike, në anën tjetër më pengonin dukuritë e korrupsionit e të krimit. Jo vetëm në LDK, por në gjithë spektrin politik të Kosovës, qoftë nga kampi paqësor, qoftë nga kampi i, i ish UÇK-së. Ky shqetësim i imi pra dhe pamundësia si individ të bëjë ndryshime të mëdha jo vetëm që më bëri të dal me partinë time reformiste Alternativën Demokratike të Kosovës, por e shqetësuar thellësisht me ndërhyrjet e Serbisë në pjesën veriore të Kosovës e që politika jonë nacionale në vend t'i jipte prioritet këtyre gjërave filloi të merrej me çështje të interesit të ngushtë. E unë u angazhova pra që së pari të provoj që këtë problem ta bëj të njohur për gjeneratën e re të vendit tonë.

Të dihet që në këtë pikë jemi të dobët pra, nuk po punojmë mjaft për të shuar strukturat paralele në veri dhe vendosa që doktoraturën time ta bëj pikërisht në këtë temë. Dhe në doktoraturën time pra analizoj dështimet e UNMIK-ut, për ta zbatuar të drejtën ndërkombëtare në Kosovë mbi Rezolutën 1244, me të cilën UNMIK-u është dashur ta administroj tërë territorin e Kosovës, ndërkohe që UNMIK-u një të tretën nuk arriti. Pra, në veri nuk arriti të shtrijë administrimin e vet dhe dështimet e faktorit vendor që në kohën kur ne morrëm kompetencat të zgjidhim këtë problem. Kjo punë e doktoraturës ka zgjatë gjashtë vjet, por në të njejtin punim unë kam analizuar edhe problemet që i krijum ne vetë me një qeverisje të dobët, me një ndryshim të interesave vendase, interesat nacional filluan interesat e ngushtë e personal të marrin prioritet. Të gjitha i vuna në doktoraturë në mënyrë që nuk e dija që mund të rikthehem në politikë, së paku të lë për gjeneratën e re një argument, një dokumentim që puna që nuk arritëm ne ta kryejmë si rrumbullakësim i shtet-ndërtimit të vazhdoj nga gjenerata e re.

Por politika më solli përsëri në qeverisje, u bëra Zëvendës Kryeministre e Republikës së Kosovës në vitin 2011, në vitin 2010 isha Ministre e Administratës Publike dhe në momentin kur kisha detyrën e zëvendës kryeministres u zgjodha kryenegociatore e bisedimeve mes Kosovës dhe Serbisë me ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian dhe përkrahjen e fuqishme amerikane. Ku praktikisht të gjitha shqetësimet që i kisha me ndërhyrjen e Serbisë në veri të Kosovës ishin tema pra nga të cilat dolën marrëveshje. Diku rreth 33 marrëveshje dhe me të cilën arritëm të shuajmë strukturat paralele serbe të policisë. Vendosëm policinë e Kosovës në veri të vendit, shuajtëm doganat paralele, shtrimë doganat e shtetit tonë, shuajtëm strukturat paralele të gjykatave e të drejtësisë, vendosëm strukturat e drejtësisë së shtetit të Kosovës.

Mbyllëm kufirin se pikat në veri pikat kufitare, Jarinje-Bërnak ishin djegur pas pavarësisë së Kosovës. Rikthyem autoritetet shtetërore në ato pika, mbyllëm kufinin. Rehabilituam ndërtesat në një mënyrë pra për këto shtatë vite të dialogut ne arritëm në shumë fusha, t'i shuajmë strukturat paralele sërbe dhe ta shtrijmë shtetin tonë në veri, ta shtrijmë sovranitetin. Problem ky që e trashëguam nga UNMIK-u, por edhe që vetë nuk patëm mundësi me e bo një qeverisje idealiste, të ndershme e të aftë që ne vetë t'i zgjidhim këto pa pasur nevoj që të shkohet deri në Bruksel. Pra këto ishin disa zhvillime që mua fare nuk më kanë pëlqyer pas luftës, vetë kam zgjedhur rrugën e reformave nuk kam pranuar të jem pjesë e këtyre dukurive negative dhe atëherë kur s'kam mundur politikisht të ndryshoj kam punuar në mënyrë akademike, pra me shkencë së paku të lë dëshmi shkencore për problemet. Në mënyrë që kur t'i vjen momenti, pa ditur që përsëri vetë do të merrna me riparimin e atyre i kam bërë këto punë pas luftës.

Para se të bëj doktoraturën, unë kam bërë magjistraturën në Universitetin e Harvardit në shkollën "John Kennedy" për qeverisje në vitin 2001 dhe 2002. Pse u shkëputa nga politika ku isha në kulmin {me duar tregon formën e kulmit} e udhëheqjes në Lidhjen Demokratike dhe vendosa të shkoj në studime. Një arsye ishte kryesore, në periudhën do të thosha tetor-dhjetor 2000 unë kam pasur tre tentim-atentate. Dhe këto tentim-atentate që për fat nuk rezultuan pra në ndonji tragjedi për mua edhe pas konsultimeve me miqtë amerikan të Qeverisë Amerikane mora vendim të largohem pak nga Kosova dhe opcionet e largimit ishin të ndryshme. Por unë kam pasë një andërr (buzëqesh) që të shkollohem në Harvard që nga koha kur lexoja për Nolin, për Fan Nolin. Dhe pastaj kërkoja bashkë me miqtë amerikanë shtigje si do të mund të mbërrij atje dhe pata sukses.

Pra, një u largova, përmirësova gjendjen e sigurisë time sepse nuk isha më target për dikend, magjistrova me suksese të larta, madje mund t'ju tregoj edhe që jam shpallur një prej pesë studentëve të shkëlqyeshëm të gjeneratës time. Kam këtu edhe atë {me duar përshkruan objektin} shpërblimin në formë shtatores që më është dhanë. Si dhe praktikisht kur jam kthyer në Kosovë, kam filluar rrugën e reformave. E dija që të jesh një reformist në një shtet të pas luftës ku kishin ra vlerat e idelazmit dhe kishin zanë vend disa antivlera nuk ishte një rrugë e lehtë. Megjithatë, kjo ishte ajo andërra ime, ai ideali im që vazhdonte që nga periudha e çlirimit, por vazhdonte edhe që nga veprimtaria e babait tim që ishte idealist dhe që ishte patriot. Pra, këto janë ato zhvillimet e pasluftës. Pastaj mund po ashtu të them që Kosova sot në dhetë vjetorin e pavarësisë ka përparime të rëndësishme, qoftë në kuptimin e vendosjes së bazave të shtetit, qoftë në kuptimin e vendosjes së institucioneve dhe infrastrukturës sepse ne dolëm të lodhur nga lufta.

Humbëm shumë njerëz, pra shkatërrimet materiale e të tjera, tragjedi që i përmenda në fillim të kësaj interviste. Praktikisht duke marrë parasysh që dolëm të dërmuar, e të shkrretëruar, jo shkatërruar por shkrretëruar. Kosova ishte shkrretëruar pra prej, prej skemave shkatërruese të okupatorit sërb, ne kemi arritur të vejmë disa baza, por nuk jemi aty ku kemi mundur të jemi. Për shembull, sot kemi marrëveshjen stabilizim-asociim dhe perspektiva jonë për integrim evropian është e qartë por

reformat duhet t'i përshpejtojmë që më shpejtë të jemi aty. Po ashtu, duhet të theksoj që pikërisht dialogu i Brukselit, ku Kosova tregohet që ishte një vend që dëshiron paqë me fqinjët, madje edhe me ish-armikun dhe është një shtet që kontribon për paqe dhe stabilitet në Ballkan dhe në Evropë. Neve na e rriti imazhin, sepse imazhi jonë u damtua shumë me dukuritë e korrupsionit.

Pra, në një mënyrë arritëm që të hapet rruga për Bashkimin Evropian, përkundër faktit që ende pesë vende anëtare nuk na njohin. Pra, pikërisht ishin disa veprime strategjike që na u mundësuan. Tani do të thosha që ajo që i duhet Kosovës është rikthimi i idealizmit, vendimi i politikanëve që kanë fuqi në Kosovë, që vërtetë të punojnë për sundimin e ligjit, që vërtetë të goditet korrupsioni, që vërtetë të ndëshkohen të korruptuarit, pasuria t'u konfiskohet. Nëse vërtetë dëshirojmë Kosovën ta bëjmë vend me perspektivë, ku investorët e jashtëm do të gjenin interes dhe do të investojnë, diaspora shqiptare do të investojë dhe kjo e papunëve në Kosovë e gjeneratës së re pra të ketë punësime dhe perspektiva. Kjo është ajo që duhet të bëjmë pra, ta bëjmë Kosovën një vend të shpresës dhe jo një Kosovë ku gjenerata e re ka vazhdimisht dilema a dëshiron të mbetet apo të largohet. Në anën tjetër arkitektura e sigurisë, transformimi i FSK-së në ushtri duhet të ndodhë sepse tashmë janë bërë 20 vjet nga çlirimi dhe Kosovës i takon ushtria jo vetëm si shtet, por për shkak të zhvillimeve të reja gjeopolitike që po ndodhin jo vetëm në Ballkan, por në gjithë botën.

Kemi rreziqe të reja që vijnë nga ambiciet gjeopolitike ruse, që në një mënyrë përçohen përmes Serbisë apo veprimtarive destruktive të Serbisë. Pastaj janë radikalizma të ndryshëm, pastaj vijnë tendenca tjera që shtetet e reja të Ballkanit nuk kanë fuqi të përballojnë, prandaj mesazhi dhe angazhimet tona tash edhe në të ardhmen duhet të jetë që Shtetet e Bashkuara dhe shtetet Evropiane së bashku duhet, jo vetëm ta rrisin angazhimin në Kosovë dhe në Ballkan, por së bashku me ne të jemi në një fron që të mos lejojmë ndikimet e Rusisë apo vendeve jo perëndimore në Ballkan, sepse liria jonë, pavarësia jonë është konceptuar e para si formim shtetëror por është konceptuar si vlerë perëndimore dhe duhet gjithë të punojmë ta ruajmë këtë angazhim, sepse vlerat demokratike janë ato që mundësojnë çdo qytetarit ta gëzojë prosperitetin, ta gëzojë lirinë edhe të ketë mundësi të zhvillimit edhe përparimit ashtu siç e ka ëndërruar dhe ashtu siç e meriton.

Aurela Kadriu: A mundeni veç me na tregu qysh është jeta juaj aktualisht, çka po ndodh aktualisht?

Edita Tahiri: Po {pin ujë}. Tani në këtë periudhë kur po bisedojmë unë kam përfunduar mandatin tim në qeveri në shtator të vitit të kaluar. Dhe këtë periudhë që jam në pushim e kam shfrytëzuar që të akomodohem në banesën time, unë jetoj tash 30 vjet në Prishtinë dhe veprimtaria ime politiko-kombëtare është 30 vjeçare (buzëqesh). Dhe për herë të parë kam bërë banesën time dhe më ka sjell kënaqësi që kisha kohë të merrem me gjëra personale. Në ndërkohë, jam duke kompletuar dokumentacionin e, e historisë. Projekti im është fillimi i memoareve, pra do t'i shkruaj memoaret e mia. Ju falenderoj se edhe ky projekt i juji është kontribut për memoaret e mia, si dhe po shpresoj që do të angazhohem për të ligjërues në ndonjë universitet në mënyrë që përvojën dhe përgaditjen akademiko-shkencore ta bartë tek gjeneratat e reja.

Aurela Kadriu: Ju faleminderit për kohën!

Edita Tahiri: Falemnderit, po ashtu!